

*"Kudo dhe gjithnjë,  
unë jam origjina  
e kordinatave  
kohore dhe  
hapsinore, bota  
është përftyrimi im"*

# gazeta



*Lexojeni,  
shpërndajeni  
miqve dhe  
mbi të gjitha,  
dorëzojeni  
armikut!*

GAZETE E PERJAVSHME · BOTUAR NGA INSTITUTI "ANTONIO GRAMSHI", TIRANE

## ★ analiza ★ 02

### Tirana

Ditët e fundit, për të mos na lënë në monotoninë e hapjes apo mos-hapjes së kutive, politika shqiptare vendosi të na englandisë me një debat tjetër, atë të qendrës së Tiranës. Këtë debat, siç e do zakoni, e krijoi...

## ★ politikë ★ 03

### Rama do të fitojë

Por fitorja e tij nuk do të bindë. Nuk është faj i Ramës. Asnjë fitore politike e asnjë partie politike e ndodhur pas rënies delikate të regjimit diktatorial nuk ka bindur. As ajo "fitore" që pritej të sillte çekun e bardhë. As terapia e shock-ut, që pa shock-uar nuk la...

## ★ sociale ★ 05

### Student i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar

Vendi ynë nuk ka shumë traditë në çështjet e rezistencës studentore. E vetmja që mund të përmendet me siguri është ajo e dhjetorit '90. Shembull ky i vetmi dhe më i lakuari deri në ditët e sotme...

## ★ greva ★ 07

### Refugjatë në ishull

Kur ti pyet nëse ka nevojë për një Kinematekë apo për një Akademi filmi në Shqipëri, përgjigja është: pa tjetër që po. Vendi ynë ka nevojë për më shumë gjëra të tilla pikërisht siç është Akademia Marubi...

## ★ përkthim ★ 14

### Rrënjët e urrejtjes

Çfarëdo qoftë rëndësia e faktorëve të tjerë shoqëruar ose kushteve, është e pamundur të kuptosh sjelljen e njerëzve të përfshirë në ngjarje të tilla pa parë në to materializimin e afekteve ekstremisht të forta të urrejtjes



# 1 VIT NË NATO!

Leart Kola

Ditët e fundit, për të mos na lënë në monotoninë e hapjes apo mos-hapjes së kutive, politika shqiptare vendosi të na englizisë me një debat tjetër, atë të qendrës së Tiranës. Këtë debat, siç e do zakoni, e krijoi politika dhe po e diskuton po politika, ndërsa populli është i lutur që të bëjë spektatorin e të shprespjës për më të mirën, edhe pse sido që të vijë puna, populli e di që më e mira nuk do të bëhet - sepse nuk mund të bëhet...

Qyteti i Tiranës është pa ekzagjerim një krematorium urban, që konsumon brenda vetes banorët e tij, duke i transformuar çdo ditë e më shumë në robotë konsumistë, që si të vetmin argëtim kanë blerjen e shitjen, dhe si të vetmin vend argëtues shohin dyqanet.

Tirana është produkt i pastër i terapisë së shokut. Shkatërrimi i gjithçkaje që të lidh me të kaluarën - dhe fillimin gjithmonë nga e para, mbi baza të qarta përfitim. Tirana e sotme nuk është më ajo që ka qenë para dhjetë vjetësh, dhe ajo e dhjetë vjetëve më parë nuk i ngjan asfale asaj të para njëzet vjetëve. Kjo sigurisht është justifikuar gjatë gjithë kohës ose me uretjen ndaj Komunistit ose me demokraci zhvillimin dhe progresin. Megjithatë askush nuk mund t'i përgjigjet pyetjes "po Parisi?", "Roma?" ose për ta aktualizuar më shumë e për ta futur në një krahasim më të ngjashëm, "po Shkup?". Mos vallë këta nuk janë të interesuar drejt progresit? Vetëm ne, vetëm politika jonë e kuptoi "progresin"?

Sot Tirana nuk i përket më askujt, e për këtë arsye askush nuk dëshiron të luftojë për të. Fëmijët jetojnë brenda mureve të Shtëpisë, në mungesë të ambienteve. E gjithë fëmijëria e tyre është lënë në dorë të shpiqjeve teknologjike dhe lojrave elektronike. Ata rriten pa dashuri për qytetin e tyre, sepse qyteti i tyre nuk iu përgjigjet me ndonjë formë dashurie.

Të rinjtë sot në Tiranë nuk kanë asnjë lidhje me qytetin, ata e konsumojnë atë, e konsumojnë nëpërmjet tymit të cigareve dhe kafeve, nën llomitjet pa sens, nën trysinë e tejkonsumit të imponuar, në konkurrencën mes bijve të të pasurve që shëtisin me makina të bukura. Ai pron dashurinë e parë në një ambient konsumi siç është kafa e qendrës. Të gjithë historitë e gjimnazit i ka në qendra tregtare, nëpër boutiques etj., institucione që e kanë zëvendësuar tashmë tempullin e dijes me pazarin e mallrave. Të rinjtë nuk e njohin qytetin, sepse qyteti nuk ishte aty kur ata u rritën.

Tirana është Tiranë sot edhe me ata baballarë e nëna që ndërsa shohin robotizimin e fëmijëve të tyre, mundohen që bërjen e ndërgjegjes që sjell pamundësi për të ndaluar tiraninë e konsumit, ta kapërcejnë me blerje, blerje dhe vetëm blerje, duke korrptuar kështu të tashmen, për të mos menduar të ardhmen. Ata nuk do të bëjnë asgjë për ta mposhtur tiraninë, sepse tashmë askush nuk e mban mend emrin e saj të dikurshëm, kur quhej Tiranë.

# Tirana



Foto nga Alket Islami

Tirana sot nuk i përket të varfërve, sepse ata thjesht nuk mund të blejnë asgjë, prandaj ekzistenca e tyre nëpër qytet është e bezdisshme, qyteti ynë di të jetë mizor me të pafytyrët që nuk kanë para të blenë veshje, apo të hardalosen në kafene. Ai i përzë e ua përplas në fytyrë me mllaf barrën groteske të ekzistencës atyre që s'kanë të hanë, e ata presin vetëm ditën që të

hakmerren me këtë rinoceront.

Tirana sot nuk i përket atyre që vijnë për të ndërtuar një të ardhme, nën trysinë e çmimeve të larta për meta katrore, një jetë e konsumuar mes një kredie dhe tjetrës. Nostalgjia për vendilindjen dhe urrejtja për vendbanimin, mllafë që nuk arrihen kurrë ta njohin qytetin e qyteti t'i njohë ata... Dëshira për të qenë këtu, dëshira për

të ekzistuar këtu, po mbi të gjitha dëshira për të mos vdekur kurrë këtu... Tirana nuk është e tyre, e nuk ka për të qenë asnjëherë.

Tirana nuk i përket as atyre që duke shfrytëzuar varfërinë dhe papërgjegjëshmërinë e përgjithshme, ndërtuan pallate të larta, për të përfutur parë të shpejta, dhe pastaj blenë shtëpi në katet e fundit të po atyre pallateve që ndërtuan vetë. Hapësira më e gjerë e shtëpive të tyre nuk i shpëton dot para këtyrë krematoriumi të madh, flaka po mbërrin shumë shpejt në dritaret e xhamta të kateve të tyre të fundit.

Tirana nuk i do artistët, se ata jetojnë me librat, me të kaluarën, ata kërkojnë akoma të gjejnë anën e bukur, prandaj Tirana i mbylli gjithë libraritë, kinematë, atelietë, teatrot. Tirana i zhdukto ato, për t'i zëvendësuar me objekte postmoderne. Ky qytet shkatërron sallën e kinemasë për të ndërtuar selinë e televizionit, ajo shkatërron atelienë për të ndërtuar lojra fati ajo shkatërron teatrin dhe e zëvendëson atë me dramën familjare. Ajo nuk e do artistin, ajo e vjell atë, sepse stomaku i ngurtë i saj nuk mund ta pranojë. Ajo i mohoq qeniet që mendojnë të kaluarën për të ndërtuar të ardhmen, ajo do vetëm të tashmen, këtë çast, këtë moment. Ajo nuk do të mbrohet nga trupat e tyre, sepse ata e përcjmojnë atë për sipërfaqësinë e saj.

Tirana nuk i do universitetet, pedagogët dhe studentët. Tirana urren dijen, sepse dija të bën të mendoheh, e ta ngadalëson procesin e nxjerrjes së portofolit. Tirana do universitetet pragmatiste, ato të konsumit, ato që diplomën e masin me euro dhe jo me dije, ato që e harxhojnë kohën duke menduar për zhvillimin e njerëzve dhe ideve por mbi shitjen e blerjen. Ata që përgatiten për të sotmen e jo për të ardhmen.

Tirana nuk ka mistere, ajo nuk eksplorohet, ajo është brutale, banale dhe e pashpirt në trajtimin e saj. Tirana konsumon vetveten e bashkë me të dhe banorët e saj, të cilët si qenie rudimentare zgjohen dhe flenë pa ëndrra, dhe një qytet që nuk ëndërron është një qytet që duhet të përgatitet të vdesë. Tirana do të vdesë sepse për të s'ka kush të luftojë, ajo ecën mbi kufomat që konsumoi vetë, dhe

mbytet nën hirin e tymin që del nga buldozerët e firmave të ndërtimit.

## EPILOG

Nga kutia aspak magjike e televizioneve, po diskutojnë disa bataqinjtë me disa bataqinjtë të tjerë për fatin e qytetit, me ekzaktesisht për fatin e sheshit të qendrës. Në pyetje është - A do të ndërtohen katër kulla 15 katshe në qendër apo jo? Ky debat ka zgjuar dhe një herë emociione dhe qytetarët janë ndarë në dy pjesë, ata që i duan dhe ata që nuk i duan kullat. Këtë diskutim qytetarët e bëjnë sa here që dalin nga shtëpitë, përgjithësisht në kafe.

Sa herë që qytetarët dalin nga shtëpitë e tyre, me shpresën që do të gjejnë dikë me të cilin të shtyjnë ditën duke diskutuar për kullat, gjatë rrugës kur ecin apo udhëtojnë me makinë, cifla të vogla pluhuri ia mbulojnë trupin dhe depërtojnë nëpër qepallat e syve. Qytetarët të pabëzdisur nga ky fakt nxitojnë për të mbërritur tek kafa më e afërt, ku pritet të konsumojnë bashkë me ditën edhe debatin mbi debatin që kanë parë në televizion. Pritet që dita të kalojë aty duke pirë kafe dhe duke diskutuar mbi diskutimet e të tjerëve. Me pas kur dita mbaron, kur gjatë mbrëmjes qytetari kthehet për në shtëpi, ciflat e pluhurit kanë renë, e ato janë zëvendësuar me një ajër të rëndë që mezi i krijon mundësinë e frymëmarrjes. Ai ngjit shkallët duke gulçuar përherë e më rëndë, derisa mbërrin tek dera, ai bën një pauzë të gjatë e të ngadaltë me bërrylat mbështetur tek dera, deri sa të dëgjojë rrahjen e zemrës, si të vetmën garanci që ka për ekzistencën e tij. Më pas qytetari futet në shtëpi, dhe drejtohet për nga shtrati, shtrihet në të me ndjesinë e tmerrshme që dhe këtë natë do të shohë ëndrra që nuk do t'i kujtohen nesër në mëngjes. Nën këtë terror mbyll sytë dhe fle, bashkë me të, në po të njëjtin shtrat është shtrirë Tirana, me sytë e zgurdulluar dhe me pamjen e përcuduar të një prostitute që sapo është perdhunuar nga një grup keqçorësish, duke shkelur kështu dhe ate pak dinjitet që i kishte mbetur. Tirana mbyll sytë pranë qytetarit të saj, për të jetuar një natë plot ëndrra që nuk do t'i kujtojë më të nesërmen në mëngjes.

Alain Badiou

Po kërkojmë një element analitik që ka të bëjë me natyrën e veçantë të çorientimit të ndërgjegjeve, çorientim që ka emrin Sarkozy. Në këtë pikë do të doja të ritrajtoja më në detaj një hipotezë të paraqitur tashmë, që deklaron se ky çorientim, i kapur në dimensionin e tij global, historicitetin e tij, kuptimshmërinë e tij, na shtrëngon të kthehemi deri në atë moment që duhet ta quajmë trashëndental të saj pétainist.

Le të saktësojmë natyrën intelektuale të kësaj hipoteze. Nuk po them se rrethanat i përngjajnë dështimit të 1940-s, as se Sarkozy i përngjan Pétainit. Aspak. Po them se subjektiviteti masiv që mban Sarkozynë në pushtet

Nga libri "De quoi Sarkozy est-il le nom ?"

## "Pétainizmi" si trashëndental i Francës

dhe e mbështet në veprimin e tij, i ka rrënjët e tij të pavetëdijshme, historiko-kombëtare, të pétainizmi. Këtë e quaj trashëndental: diçka që, pa u shfaqur në sipërfaqe (prej ku edhe situata jonë nuk i "përngjan" sekuençës së mbretërimit të Pétainit), konfiguron nga larg dhe i jep ligjin dhe rendin e vet njëzëri ndërvendosjeje kolektive. E kam përdorur tashmë këtë koncept (pika 8, e botuar në Gazeta) për të qartësuar atë që kuptohet me shprehjen parashtruese: "ekziston një botë e vetme".

Në rastin e vendit tonë, emërtimi

i këtij trashëndentali "pétainist", na ndihmon të mos e emërtojmë dobësisht antidemokratik ose bonapartist (janë cilësime "të majtë"); të mos e cilësojmë fashist ose parafashist, gjë që do të ishte e tepruar, ultra e majtë.

Propozoj të thuhet se "pétainist" është, në Francë, trashëndentali i formave të shtetëzuara dhe katastrofike të çorientimit. Kemi një çorientim të madh që shfaqet si kthesë brenda situatës dhe që, në mënyrë solemne, është veprues në krye të shtetit. Nga ky këndvështrim, ende formal, ekziston një traditë kombëtare e péta-

inizmit që shumë përpara Pétainit. Pétainizmi fillon realisht në Francë me Restaurimin e 1815-ës. Një qeverisje post-revolucionare rivendoset në qendrat e të huajve me mbështetjen e fortë të emigrantëve, të klasave të përmbytura dhe tradhtarëve dhe oportunistëve të çdo soji, dhe me pranimin e një populli të lodhur. Kjo qeverisje deklaroi se po rivendos rendin dhe moralitetin publik kundër anarkisë të përgjakshme të revolucioneve...

(Vijon në faqe 12-13)

Rama do dështojë se nuk ka në plan asnjë ndryshim real. Asnjë plan përveç këtij aktual

# Rama do të fitojë

*Kush do të ishte reflektimi duke i dhënë votën Ramës?*

Andi Kanana

Por fitorja e tij nuk do të bindë. Nuk është faji i Ramës. Asnjë fitore politike e asnjë partie politike e ndodhur pas rënies delikate të regjimit diktatorial nuk ka bindur. As ajo "fitore" që pritej të sillte çekun e bardhë. As terapia e shock-ut, që pa shock-uar nuk la. Tashmë është matematike që sistemi i ri parademokratik nuk funksionon. Për 20 vjet me radhë është besuar në mënyrë të verbër (nga halli) që fajin e ka njeriu-politikan, për moszwillimin e vendit. Kronologjia në memorie më bën të kërcej nga Hoxha tek Alia, nga Berisha tek Fino, Nano apo prape Berisha. Pritej infrastruktura e rrugëve me ndihmën e ndërkombëtarëve. Të ktheheshin tek i zoti lekët e marra nga Sudja me ndihmën e ndërkombëtarëve. Të luftohej korrupsioni me ndihmën e ndërkombëtarëve. Të riluf-tohej korrupsioni me ndihmë (kot që ta them) të ndërkombëtarëve. E njëjta këngë me pak tekst. I njëjti refren mo-ton.

Pritet Ed Rama në radhë e gjatë, që të zhgënjëj pas shumë pritje plot pasion. Sot e kësaj dite ndoshta është mirë që analizën ta bëjmë para se hatanë t'ja mveshim politikanit tjetër në radhën serioze të drejtimit të vendit. Pyetja që po na mundon është ajo e gabuara: A do të jetë apo jo Rama i pa-përgjeshëm si çdo politikan tjetër në histori, aq sa histori na është treguar? Sigurisht që po. Përgjigjia nuk ka të bëjë me dëshirën njerëzore mesa duket. Janë rregullat e lojës që nuk funksionojnë, dhe pa to nuk ka si të funksionojë sistemi i gjithë, qoftë dhe i komanduar mirë nga një njeri i vetëm; aq më tepër në një situatë të tillë të një papërgjeshmërie kolektive post moderne.

Do të ndodhi ajo brenda vetes e ndjeshmë të gjithë. Rama do të fitojë por asgjë nuk do të ndryshojë. Të jemi të sigurtë për këtë. E majta e shqiptare e kompleksuar nga historia e saj do të silltet si një e djathtë e devotshme. Reformat ekonomike do të jenë të pre-gatitura në imtësi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar; dhe njëlloj do shkohet përpara në rrugën e "kishës" liberale. Kjo do të sjellë si produkt të prekshëm mijra orë debati televiziv ku Partitë e mëdha do të kundërshtohen me forcën e batutës duke qënë dakort deri në simbiozë.

Kush do të ishte reflektimi duke i dhënë votën Ramës? Nëse ekonomia do të ecë njëlloj keq në rrugën e vet; nëse zhvillimet politike do të jenë njëlloj të orkestruara nga ndërkombëtarë të bezdisur nga dita pa emocion në Tiranë; nëse do të na flitet për ditë për lëshime europiane të dozuara me pikatore farmacisti në rrugën



drejt europës, atë rrugë që ne po e ndjekim me emocionin e një të hipnotizuari; ku do të jetë ndryshimi që do të bindë?

Rama do dështojë se nuk ka në plan asnjë ndryshim real. Asnjë plan përveç këtij aktual që po të rrotullosh kokën është në krizë të plotë.

Kriza financiare botërore nuk solli asnjë moment reflektimi për mënyrën sesi duhet të organizohemi në raport me ekonominë. Kriza botërore u jetua me qetësinë e një vendi që mban në shpinë prej krijimit të tij vetëm krizë monetare. Nuk mund të mohohet mes rreshtave dhe pak kënaqësi me karakter sadist. Ndoshta se duke mos patur asnjëherë shansin për të jetuar nga jashtë një krize aq më tepër globale, tani jemi në kushtet e ekspertëve. Rama nuk do të ndryshojë bindjen (dhe as e di që duhet ta ndryshojë) se dhe ne jemi pjesë e një bote që ka kriza.

Nuk pati frikë për krizën financiare që mund të na trokasë në derë; pse të trembemi kur nuk kemi patur kurrë para aq sa për të humbur. As banka e Shqipërisë dhe asnjë ekonomist nuk ka marrë përsipër të kontrollojë pasojat që sjellë virtualiteti pasurimit në sistemin e bankave. Shqipëria ka arsye për tu trembur. Shqipëria ka patur dhe eksperiencën me efekt të përshpejtuar të bankave normale. Pasurimi komplet virtual në firmat piramidale nuk është më shumë se veprimtaria e bankave më të mira në ditët e sotme. Asnjë bankë sot për të dhënë një shembull nuk arritur të bindë me aq

shpejtësi sa arritën të ashtu-quajturat firma piramidale. Asnjëherë nuk ka patur kreditorë aq të devotshëm, dhe investues me më shumë shance për të gjetur kredi të shpejta se në kohën e para 97 në shqipëri. Jo vetëm që nuk pati dyshime as pyetje për sistemin aktual të bankave por historia e atyre viteve po konkurohet dhe sot. Pas bunit të ndërtimeve gjithkush mund të marrë kredi pa shumë garanci nga bankat për të blerë shtëpi. Vetëm se efekti i mos pagimit të këtyre kredive mund të shihet pas disa viteve. Rama nuk do të dalë kundër sistemit të kreditimit se realisht duket se beson tek ky sistemi virtual i pasurimit.

Besimi i verbër tek tregu pas investimeve aspak të kontrolluara apo të matura të individit dhe ndihma e marrë nga bankat të cilat më pas e reflektojnë tek aktiviteti i tyre nuk po vihet asnjëherë në dyshim. Avantazhi i shtuar prej krimi të organizuar dhe botës informale duket sikur do të jetë i pa fund, por faktet tregojnë se dhe kjo teknikë mbijetesë i ka orët e veta më të pakta.

Raporti i cuditshëm prej vasali me FMN ka bërë që në vitin '97 shteti shqiptar mos ndërhynte në shumangjen e rënies së firmave piramidale duke cuar në rrëzimin përfundimtar të ekonomisë shqiptare. Sipas logjikës së FMN ndërhyrja do të sillte prishjen e ekuilibrit në treg. A thua se tregu funksiononte në Shqipërinë e atyre viteve. Në të njëjtën situatë FMN nuk e pengoi shtetin Amerikan të ndërhynte për të shumangur rrëzimin e banka-

ve të atjeshme. Pavarësisht sjelljes me dy kandarë të organizmave të huaja asnjë politikan nuk ka qënë i gatshëm të dalë kundër. Kjo nuk ka penguar as popullsinë që të jetë dakort me veprimet e disfavorschme. Rama nuk që të dalë kundër të gjithëve. Rama do vota si çdo politikan normal.

Rama nuk do të ndryshojë asgjë, është e sigurtë. Nuk ka asnjë shanc që ai të dalë kundër ndërkombëtarëve, në interes të vendit. Asnjë politikan shqiptar nuk mund të bëjë. Politika sot është kthyer në një parashikues së shpejti të publikut. I gjithë sistemi mundohet të kuptojë atë që ne zhargon quhet "këtë do populli". Si në një adoleshencë e përzgatur kur e dashura ish e bukur jo se të pëlqente vetë, por se ta pëlqenin shokët.

Media bën emisione pa patur asnjë testues, por me parandjenja të caktura që parashikojnë shijen popullore. Biznesi prodhon gjithçka që duket mjaftueshëm e përceptuar nga shqiptari i mesëm. Dhe politika në mënyrë komplet meidokër mban hapin e sistemit, paçka se kjo mund ta shkatërojë në një të ardhme të afërt. Pas çdo skandali që ka dhe indinjatë popullore ka kor politikanësh që aprovon pa mëdyshje. Inteligjenca e politikanëve ka ngecur tek niveli që ata pritet të jenë nga të tjerët. Asgjë më shumë. Prandaj nuk është çudi kur numëron me mendje 130 emra nga 140 të politikës që nuk krijojnë veç bezdi. 10 prej tyre nuk të kujtohen as nëse ti tregojnë më foto profilin si në polici. Rama është dirigjenti 60 depu-

tetëve. S'ka alibi për të.

Rama do zhgënjëj. Rama përveç se është i detyruar të jetë jo i lirë në zgjidhjet e tij të kushtëzuara nga ajo që Rama beson se njerëzit duan: por dhe dashuria e tij për liberalizmin nuk do ta lënë të bindë. Po të jemi me fat do të futemi në listën e vendeve me ekonomi tregu sipas manualit liberal. Do të prenotohemi për krizat ciklike te sistemit. Sa herë pasuria virtuale të ketë kaluar cakun do të varfërohemi brenda një ditë. Do ta quajnë krizë. Përsëri do do varfërohemi duke menduar që fajin e kemi vetë. E keqja është se bankierët që do ta kenë shkaktuar krizën do vazhdojnë jetën e tyre pa humbur asgjë nga pasuria e tyre virtuale. Ne do kemi në dorë që demokratikisht të zhgënjehemi nga Politikani i radhës, Rama apo kushdo tjetër pas Ramës.

...

Pyetja në vend të epilogut do të ishte: Po a mund të ishte Rama heroi që dhe i vetëm mund t' i ndryshonte gjerat në këtë kaos post modern dhe papërgjegjshëmri kolektive? A mund t'i kërkojmë Ramës të jetë hero në kohën kur heronjtë janë kaq qesharak. Naiv të shkrëtë që dhanë jetën për këtë vend (cilindo vend). A ka vend që Rama të jetë në të njëjtën radhë me Shkurte Pal Vatën, Ismet Sali Bruçën dhe durrësakun Adem Reka që shpëtoi portin nga shkatërimi?

Rama do fitojë, është thjesht çështje kohe, por mos i kërkonit asgjë. Vetë i keni vrarë heronjtë më të post të qeshurën post inteligjente.

Ne ende nuk e pranojmë mundësinë që njerëzit ta lexojnë realitetin në mënyra të ndryshme

# Burri dhe muri

*Negociatat politike dhe ekonomike në Shqipëri dështojnë*

**Ardian Vehbiu**

Partitë politike në Shqipëri dhe, në përgjithësi, të gjitha palët në spektrin politik, e konsiderojnë dialogun si mjetin kryesor të komunikimit me Tjetrin; qoftë ky aleat, partner ose kundërshtar.

Po çfarë është pikërisht dialogu? Zakonisht, e përkufizojnë si formë komunikimi (negociatë) e cila ka për qëllim t'i ndihmojë palët të arrijnë marrëveshje. Disa bëjnë dallim midis dialogut, dhe formave më konfrontative të komunikimit, si diskutimi ose debati (polemika), meqë këto të fundit nuk synojnë doemos marrëveshjen.

Nga pikëpamja komunikative, dialogu midis dy palëve themelohet mbi një kod të përbashkët, që duhet të jetë gjuhësor (pragmatik), sikurse mund dhe duhet të jetë kulturor (simbologjik) dhe logjik (racional).

Megjithatë, premisa kryesore e dialogut është gatishmëria e palëve për t'i ndryshuar pozicionet, zakonisht nëpërmjet njohjes me informacion të ri ose arsyetimit ose kompromisit.

Dialog ideal do të ishte ai ku të dy palët do të niseshin nga pozicionet e tyre fillestare për t'u afruar një pozicioni të tretë që nuk koincidon me asnjë prej pozicioneve të pikënisjes.

Për shembull, kur njëra palë kërkon kriminalizimin e përdorimit të marrëveshjes, ndërsa tjetra liberalizimin e përdorimit të saj, dialogu mund të shpjerë në një kompromis të tillë, që të pranojë ndëshkimin me ligj të vetëm kujt kapet me sasi të mëdha droge. E rëndësishme këtu, megjithatë, nuk është gatishmëria për kompromis, por gatishmëria për të arsyetuar së bashku me tjetrin.

Për fat të keq, kultura tradicionale e shqiptarit nuk e pranon lehtë këtë formë komunikimi. Kjo do të thotë që instinktivisht, do t'i shmangem dialogut ose do t'i referohemi vetëm si mjet ose manovër taktike, për të arritur qëllimet tona fillestare.

Për këtë arsye, shumë negociata politike dhe ekonomike në Shqipëri dështojnë, meqë palët në thelb nuk lëvizin dot prej pozicioneve të tyre të fillimit; ose edhe kur kanë sukses, kjo ndodh për shkak të



faktorëve që nuk kanë të bëjnë fare me dialogun (shantazhi, korrupsioni, kërcënimi, imponimi nga një autoritet i jashtëm etj.); ndërsa të tjera negociata përfundojnë me sukses kur palët arrijnë në kompromis, por vetëm meqë binden se kompromisi u vlen më shumë sesa vazhdimi i konfrontimit; jo sepse binden që kompromisi është më i arsyeshëm sesa pozicionet e tyre në pikënisje.

Po të vëresh mënyrën si shtjellohet lufta politike në parlament, në tribunat e tjera publike dhe në media në Shqipëri, nuk mund të mos vësh re se një nga teknikat argumentative që përdoren më shpesh ka të bëjë drejtpërdrejt me gjetjen dhe publikimin e kontradiktave në qëndrimet e kundërshtarit në kohë të ndryshme.

Kjo teknikë themelohet mbi një supozimin se ndryshimi në qëndrimet dhe në pikëpamje është tregues i dobësisë, hipokrizisë ose gënjeshtres; dhe se politikanin i vërtetë ose "burrnor" është ai që nuk ndryshon kurrë mendim. Muri lu, burri s'lu, thotë fjala e urtë. Burimi i këtij keqkonceptimi duhet kërkuar në mendësinë autoritare tradicionale të shqiptarit, e cila gjithnjë gërshtohet me patriarkalizmin.

Një etikë e tillë që ia heq të drejtën morale ndryshimit, nuk mund të bashkëjetojë me nevojën për dialog të mirëfillt; meqë dialogu në vetvete është i pamundur pa ndryshimin në mendime dhe pikëpamje të palëve të përfshira, si pasojë e vetë pjesëmarrjes në të.

Kjo kontradiktë është kaq e fortë, sa praktikisht e bllokoi komunikimin normal midis palëve, në një shoqëri që kërkon të jetë pluraliste; meqë dëshira e sigurtë për dialog gjithnjë ndëshkohet nga ajo normë morale, që e lexon ndryshimin si simptomë ose provë dobësie ose tradhtie; dhe palët kanë frikë të ndërrojnë mendim, sepse kjo do t'ju merret automatikisht si dobësi.

Natyrisht, nevoja më e ngutshme për dialogun si formë komunikimi publik ndihet pikërisht në ato fusha midis sferës së rregulluar me ligj (ose në mënyra formale) dhe sferës ku individit mund të veprojë krejtësisht i lirë; pse pikërisht në këtë hapësirë të ndërmetme lindin konflikte të cilat s'mund të zgjidhen

duke dërguar policinë, ose me rrugë gjyqësore.

Ideja se kjo nevojë mund të mënjanohet, së bashku me ambientin përkatës, duke i shtuar dhe detajuar ligjet, normat dhe rregullat e ndryshme është e përcaktueshme; meqë gjithnjë do të vijë një moment kur rregullime të tilla formale do të bien ndesh me lirinë e veprimit të individit, të grupit, ose të institucionit.

Pa folur pastaj për faktin që, historikisht, çdo ligj nuk është veçse produkt i një dialogu mes ligjvënësve, ose i një dialogu tjetër, më të tërthortë, midis praktikave që e kanë kristalizuar, në rrjedhë të kohës; madje edhe në ato raste kur na duket sikur ligji nuk është veçse një arbitraritet me të cilin tashmë jemi mësuar, siç mësohet birra me formën e shishes.

Megjithatë, e për t'u kthyer në realitet, në leksikon e sotëm të shqipes publike, fjala dialog shpesh nuk është veçse një etiketë e ngjitur mbi një fluskë; meqë koncepti i referohet jo aq gatishmërisë për t'u qasur një zgjidhjeje ose marrëveshjeje në bashkëpunim me kundërshtarin, sesa dëshirës dinake për të vonuar lojën, ose për të fituar kohë derisa raportet e forcave të ndryshojnë në favorin tonë në mënyrë të tillë, që të mund t'u imponohemi kundërshtarit me forcën e votës, ose të autoritetit, ose të kobures.

Shkaku kryesor i kësaj ngacjeje është se, megjithëse tani mund të flitet për barazi të palëve në konfliktet publike, ne ende nuk e pranojmë dot pluralizimin ose mundësinë që njerëzit e ndryshëm ta lexojnë realitetin në mënyra të ndryshme; prandaj bisedat dhe negociatat me Tjetrin gjithnjë i përfytyrojmë si përplasje midis së vërtetës sonë dhe gabimit të palës tjetër, të mirës sonë dhe të keqes së palës tjetër, të së drejtës sonë dhe kriminales së palës tjetër.

Kjo do të thotë edhe që, po t'i modifikonim dot rrethanat sipas dëshirës ose vullnetit tonë individual, ne mosmarrëveshjet politike gjithnjë do t'i zgjidhim nëpërmjet imponimit, me hir a me pahir; dhe se dialogut i drejtohem vetëm kur nuk kemi alternativë tjetër komunikimi me kundërshtarin ose partnerin. Shpesh është pikërisht kjo hipokrizi që e komprometon dialogun që në pikënisje.

Eriona Cami

Vendi ynë nuk ka shumë traditë në çështjet e rezistencës studentore. E vetmja që mund të përmendet me siguri është ajo e dhjetorit '90. Shembull ky i vetmi dhe më i lakuari deri në ditët e sotme.

Synimi i studentit në ditët e sotme nuk është ai i Raskolnikovit të Dostojevskit. (Mos o zot të ishte i njëjtë!). Synimi i studentit të sotëm nuk i ngjan as për së largu studentit të Prishtinës në 1981, 1989, 1997.

Synimi i studentit të sotëm është pikë për pikë i njëjtë me atë të një zyrtari institucionesh, të cilit institucioni nuk i ka bërë gjë tjetër veçse e ka institucionalizuar brenda sistemit të tij. Ai pra, qënia student nuk e ngre më zërin për padrejtësitë që ndodhin por shpreson (s'dihet ende nga buron kjo shpresë) ashtu i përuhur se një ditë e gjitha do të mbarojë dhe do të jetë edhe ai Shef i s'ka rëndësi se kujt gjëje.

Nuk flitet më as për gjendjen e së drejtës, as për pronën publike, as për të drejtat e studentit që për meritë të luftës së të tjerëve diku larg prej tij i takojnë tashmë. Sepse qartazi shqetësimi për to është i një rendi tjetër, rend i cili nuk të bën Shef të asgjëje madje të harxhon koha nga koha e vyer për konsolidimin e memeco-shurdhërisë. Ndonëse ai e quan veten jurist, politolog apo financier, profesione këto të lakmuara, dinjiteti i tij duket se nuk preket më, edhe pse nuk ka më një tillë në fakt, duke pranuar tashmë të gjithë padrejtësitë dhe tekcat e fatit, më keq se prindi i tij para viteve '90.

Figura e tij nuk ka as lidhjen më të dobët me atë çfarë përfaqësonte studenti i viteve '68, i cili revoltohet si fillim për ndalesën e të jetuarit bashkë vajza e djem. Sot, figura e tij lidhet me atë të individit që nuk ka as ndjeshmërinë minimale se mësimi i së drejtës, filozofisë, politikës, sociologjisë zhvillohet në godinën e fakultetit të infermierisë apo në akademinë e rendit. Ai degdiset nga njëri vend në tjetrin, nga njëra godinë në tjetrën, duke harruar kështu bashkë me leksionet mjerane edhe adresat që përbëjnë në fakt vendet. Banesën pra Universitetin. E kjo vetëm e vetëm se do të realizojë të shpresën e tij, atë të studimit e diplomimit. Aipse shteti ynë nuk ja plotëson akoma dot kushtin e domosdoshëm, godinën, adresën e studimit. Kështu e kupton ai mesa duket moshën e internetit.

Po, po, qesharake por dhe e dhimshe në të njëjtën kohë. Një mikështja ime e përmend gjithmon se ambienti aty "të kalit", i ftohti, laqështia, serumet, ushtarët, vrapit dhe arma e tyre ndërkohë që në të njëjtën godinë flitet për të drejtat e homoseksualëve, diskriminimin pozitiv, të drejtën publike përballë private, Aristotel, Platon etj, etj. Kësaj i thonë, të njëjsh drejtëpërsëdrejti me fenomenet sociale.

I gjithi ky ambient duket njësoj si tek "Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur", ku të gjithë ushtarët thërriten

Jeta e tij tashmë është ajo e një privatizimi total, private i futur gjeri në palcë

# Student i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar



por asnjëri nuk përgjigjet, përpara komandantit heshtin të gjithë. Mirëpo, ushtarët ishin të vdekur dhe kjo dihet. Po studentët... gjallë a vdekur njëkohësisht? Gjenerali i kësaj ushtrie të gjallë e të vdekur është urgjencia e veprimtimit përkundër masakrës publike.

Asnjëri nuk di të thotë asgjë, pasi sa herë që i pyet vetëm një lloj përgjigje: "Ç'më duhet mua, ta mbaroj këtë shkollë se nuk i dihet dhe le ta mari lumi pastaj". Më mirë në fakt do ishte po të thoshte "Ç'më duhet mua ç'bëj unë?" po kjo kërkon të paktën të jetë lexuar Zhevjku.

Ky popull studentësh harron se në këtë vend do të kalojnë jetën. Ashtu si ata po të njëjtin shkollim do të marrin dhe fëmijët e tyre që do të lindin në këtë vend. Po këtyre të fundit kush do t'i japë mësim? Kush do të di t'i përgjigjet? Një mësuese matematike që matematikën e ka bërë dy herë në javë, një mësuese letërsie që ka lexuar vetëm shtypin e ditës apo pedagogu i së drejtës, i cili nuk di të dallojë akoma pronën publike nga ajo private. Apo për ta ngatëruar më shumë, pronën shtetërore me atë publike.

Studenti i sotëm nuk do t'ia di më se çfarë ndodh me qytetin. Ai në fakt është më i huaji i qytetit. Ai gati gati i kalon tangent qytetit. Kështu që vendet që do të ishin adresat e përhershme të tij janë pikërisht ato të indiferencës sublime që mishërohet në të. Atëherë pse duhet të di ai se çfarë ndodh me kinemanë, me kinostudion, me sheshin, me arsimin, me të ardhmen, pra atë ç'është dhe mund të jetë publike në vendin e tij? Në fakt po të vëzhgoni me vëmendje popullin student është mbledhur në "hallet e tij", diplomë shpejt e shpejt, karrierë (s'dihet ku) por mbi të gjitha posedimin e adresës se ku do të shitet më shpejt.

Të gjithë sot që kemi marrëdhënie me universitetin, dëgjojmë të na flitet për atë se çfarë është ligji, shteti, institucioni duke na treguar kështu se si është dhe duhet të jetë qytetari i ardhshëm. Por kjo s'është për t'u

thënë e për t'u bërë dhe jashtë mu-reve të universitetit. Kot nuk thonë "aaa në shkollë i kës mësuar këto? S'bëjnë për në jetë.

Kështu që Qytetari i ardhshëm nuk flet më për jetën e qytetit, nuk do t'ia di më për të ardhmen e vendit në të cilin ai jeton. A thua se është qiraxhiu i rradhës dhe nga çasti në çast mund të ndërrojë banesë. Ai qëndron i struktur nëpër kafe pafund me po të njëjtën shpresë "se më mirë do të bëhet"!!!

Vizioni që ai përfaqëson është njësoj si betoni i qytetit, pa frymëmarrje, pa hapësirë të gjelbër, pa shesh publike, pa kinema, pa teatër... të cilat ndonëse të pakta në numër po mbyllin dita ditës. Madje të flasësh për to është pak jashtë kohe edhe përgjithësisht etiketohesh si tip që s'do bësh dot hajër.

Studenti i sotëm është qytetari i ardhshëm dhe vizioni që ai përfaqëson është mënyra sesi do të vazhdojë rrjedha e historisë ky vend. Po ku e si po përgatitet ky student? Ai përfaqëson të ardhmen e shitjes së vetes për një vend pune. Jeta e tij tashmë është ajo e një privatizimi total, private i futur gjeri në palcë.

Ai nuk përfaqëson asgjë nga statusi si student i një universiteti apo një akademie e cila përfaqëson publikën më së shumti, por vetëm atë të studentit të private, student i një "sh.p.k-je" që po ta thuash më gjatë është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Tashmë nuk na bënë më asgjë përshtypje, jemi të gjithë të mbledhur nëpër apartamentet tona, me shpresën se dita-ditës do jemi më të pasur dhe do t'i shtojmë akoma dhe më shumë si fqinj ynë përballë, të cilin e shohim vetëm në shkallë pasi sheshet publike janë privatizuar.

Deri sa të bëhemi titullar institucioni, ministër apo kryetar dhe të marrim nga një hyrje në kullat që do të ndërtohen tek sheshi "Skëndërbej" po vazhdojmë të jetojmë me shpresat se një ditë do jetë më mirë në qytetin tonë të përbashkët.

Si mund të jetë i shenjtë një objekt i besimit islam kur nxitja fillestare për të vjen nga ndërtimi i një kishë

# Kullat me shenja dhe herezia qytetare

## Debat për kishën e re dhe xhaminë e re në sheshin e Shkupit

Artan Sadiku

Herezia është vepër që tenton dhe kërkon ndryshim në një sistem të vendosur të besimit apo të bindjeve të etabluara të autorëve të atij besimi, sistem që autentikisht është i përfaqësuar nga religjioni. HEREZIA QYTETARE në kontekstin tonë të realitetit neoliberal nënkupton diskursin qytetar që kundërshton doktrinën tradicionale, në të cilin religjioni dhe nacionalizmi janë determinuesit kryesor. Ky model i marrëdhënieve të forcës në shoqëri është tipik veçanërisht për vendet e Evropës Jugore e Lindore në të cilat depërtime liberale arrijnë të realizohen kryesisht në formë të herezisë dhe jo të 'mainstreamit'. Realiteti neoliberal ekziston në nivelin global, ndërsa toleron ekzistimin e hapësirave të realitetit ku luftojnë tradiconaliteti dhe liberalizmi, rizbulon veten dhe nga këto hapësira 'të luftës' thith arsyen e ekzistimit. Tendencat e neoliberalizmit në shoqëritë ballkanike janë kryesisht, nëse jo ekskluzivisht individuale dhe aspak procese të grupeve dhe masave.

Lufta aktuale në realitetin në Maqedoni zhvillohet në mes tendencave për vendosjen e objekteve religjioze në sheshin e Shkupit dhe kundërshtimit 'heretik' ndaj tyre. Grupet e kësaj lufte i nënshtrohen përplasjeve të tradicionales dhe liberale, ku përkrashtet e kishës së RE dhe xhamisë së RE, apo vetëm njëres prej tyre janë në taborin tradicional ndërsa liberalët heretik janë grupi më i vogël i kundërshtuesve të kësaj ideje religjioze. Edhe pse vetë jam ndër heretikët e këtyre ditëve, kritikën ndaj ndërtimit të objekteve të REJA religjioze në shesh nuk do ta ndërtoj mbi bazat liberalo-klasike apo neoliberales për vet faktin që këto diskurse në pah tolerancën, vuajnë nga një jotelancë thelbësore kur e debatojnë religjionin. Në tregun e lirë liberal të ideve, është e paimagjinueshme të mbi-sundojnë idetë religjioze në debatin politik por ato mbyllën në hapësirën private shpirtërore. Insistimi liberal për sekularizim përmes zvogëlimit të rolit të religjionit në shoqëri shfaq një formë autonome liberale të mendjembullësisë. Dhe, kur religjioni del nga sfera private dhe pretendon të kontrollojë qështjet publike dhe të regullon marrëdhëniet në shoqëri dhe në shtet, përgjigjen e qartë që e merr nga liberalizmi është që një religjion i tillë është çerdhe e ekstremizmit, fundamentalizmit, fashizmit, armikut të të mirës publike, tiranisë dhe regjimeve të diktaturës. Të diskutuarit e religjionit në shoqërinë neoliberales nga një perspektivë e tillë nuk e merr seriozisht rendësinë dhe fuqinë shoqërore që ende e posedon religjioni, të pak-

tën në vendet e Evropës Juglindore, prandaj një argumentim nga ky pozicion vet për vete nuk është përmbajtësor. Bile edhe në kuadër të Unionit Evropian, në vitin 2004 evropjanët debatonin lidhur me çështjen që preambula e Kushtetutës Evropiane të përmend krishtërimin si element themelor të trashëgimisë Evropiane. E nga ana tjetër, trashëgimia më e vlefshme e Evropës moderne është ateizmi dhe Evropa është civilizimi i parë dhe i vetëm në të cilin ateizmi është opcion plotësisht legjitim që nuk paraqet pengesë për asnjë post publik, gjë që e bën Evropën moderne një hapësirë unike.

Debati për kishën e RE dhe xhaminë e RE në sheshin e Shkupit, duket të merr parasysh të gjitha rrethanat dhe arsyet e mësipërme dhe në argumentimin rreth kishës dhe xhamisë, ne duhet ta marrim gjithë sistemin me shumë seriozitet se sa që e merr ai veten. Prandaj në vend që ta shajmë dhe përqeshim qeverinë dhe institucionet fetare ne duhet logjikisht ta arsyetojmë iracionalitetin e vendosjes së kishës dhe xhamisë në sheshin e Shkupit. Ideja për kishën në shesh lindi nga VMRO-DPMNE që nuk është asnjëfarë lloj institucioni religjioz, por parti politike që qeveris shtetin. Projektet e partive politike dhe qeverive në shtetet sekulare mund të kenë vetëm karakter politik. Çfarëdo lloj flirti politik me kishën e cënon sekularizmin e shtetit, që në rastin e projektit për kishën dhe dhurimit të tokës në shesh KOM-it, u shkelën parimet e përgjithshme kushtetuese të shtetit dhe shoqërisë. Për shkak se iniciativa nuk erdhi nga një grup besimtarësh apo nga një institucion religjioz, kisha në shesh nuk mund të jetë kishë në kuptimin e vërtetë të fjalës, do të jetë e privuar nga përmbajtja e vet. Ky objekt para së gjithash do të jetë objekt politik, në të cilin besimtarët nuk do të mund të gjejnë përmbajtjen shpirtërore religjioze. Kjo KULLË do ta shfrytëzon kryqin përmbi të për të përfutur sadopakë simbolikë religjioze, ndërsa religjionin do ta përdorë për të arsyetuar ekzistimin e saj. Asgjë shpirtërore në lidhje me këtë kullë. Kishat në sheshet e kryeqyteteve të Evropës dhe gjithkund rreth botës plotësojnë dy funksione, atë simbolik, të trashëgimisë shpirtërore, kulturore dhe historike dhe funksionin ritual, atë të kryerjes së riteve fetare në të. Kisha e propozuar në qendër nuk do të plotësojë funksionin simbolik për shkak se ajo do të jetë një kishë E RE që nuk ka asnjë simbolikë dhe nuk bart asnjë trashëgimi. Përrallat për rindërtimin e Shën Konstantinit dhe Elenës i kanë demaskuar vetë ideatorët me zgjedhjen e një prej disa modeleve të prezantuara



për ndërtimin e kishës. Në konceptin e rekonstrukcionit arhitektonik ekziston nocioni i replikës së një objekti komplet të shkatëruar si formë më ekstreme e rekonstrukcionit, por që ndërtimi i ri bëhet strikt i ngjashëm me atë të mëparshmin, e që nuk është rasti me kishën e RE. Funksionin ritual besimtarësh veçmë e kryejnë në kishat që janë pothuajse në sheshin e qytetit, atë në anën tjetër të urës dhe pranë Operës dhe Baletit. Nuk është që këto janë të stërmbushura dhe të ketë nevojë për një kishë të re në shesh, në fakt në kishën qendrore në Shkup rrallë gjen më shumë se pesë persona gjatë ditës. E mbetur pa dy funksionet themelore, shtrohet pyetja se çfarë funksioni do të luajë kisha e RE në shesh. Funksionet që kjo kishë do të ketë ngelen thellë (pa)njohura në mendjen e sëmure nga rejtingu të një lideri populist me elemente fashizoide. Ndoshta funksioni i shënimit të territoreve me kryeq, provokimit, diskriminimit, monopolizimit, zaptimit, getoizimit, dhe ide tjera tipike për këtë lider ballkanik. Ideja për kishën e re reduktohet në ÇMENDURI.

Ideja për xhaminë e RE në shesh lindi si reaksion ndaj idesë së kishës dhe jo si një kërkesë autonome e be-

simtarëve. Si mund të jetë i shenjtë një objekt i besimit islam kur nxitja fillestare për të vjen nga ndërtimi i një kishë. Pra, edhe kjo KULLË me shenjë dhe gjysmëhënës do të jetë e privuar nga përmbajtja e vërtetë shpirtërore e saj, njësoj si edhe kulla e saj partnere që në rastin më të keq do të qëndron përballë saj. Por iniciativa e paraqitur në mënyrë të tillë paraqet një gabim konceptual dhe bën një dëm përmbajtësor. Ideja për xhaminë e arsyetoi idenë për kishën. Propozimi për xhaminë e NORMALIZO ÇMENDURINË. Argumentet që është çmenduri të ndërtohet objekt religjioz (ortodoks) në sheshin e kryeqytetit të një shteti multietnik dhe multikonfesional por para së gjithash të deklaruar liberal sekular, pësuan goditje të fuqishme me paraqitjen e kërkesës për të pasur edhe xhami në atë shesh. Përfundimi: është normale të kesh objekte fetare në shesh të Shkupit. Me këtë veprim iniciatorët e idesë së xhamisë i bënë shërbimin më të madh të mundshëm liderit të çmendur të shtetit. Pasi që u normalizua çmenduria, i tërë procesi tani hudhet në terrenin procedural ku xhamia 'nuk ka gjasa'. Tani vendim për xhaminë duhet të merr këshilli i Komunës Qendër i cili një gjë të tillë

nuk do të jetë i gatshëm ta bën edhe shumë vitë pasi Komuna e Çairit të jetë e gatshme të vendos bust të Nikolla Karevit në sheshin Skenderbeu.

Në vend që të kundërshtoheshit ndërtimi i kishës me një zë shumë më të fuqishëm, me ngritjen e zërit PËR xhami të RE, zëri i kundërshtimit është reduktuar në numrin e vogël të heretikëve qytetarë liberal, që tani kundërshtojnë të dyja KULLAT ME SHENJA. Hapësira publike në vend se tu takon qytetarëve do tu takon besimtarëve, edhe atë në versionin më të keq, në atë diskriminues. Qytetarët, janë plotësisht të përjashtuar nga ky proces i vendosjes së KULLAVE dhe kjo është e patolerueshme dhe e pafalshme. Sheshi i Shkupit ka dy opcione: të bëhet diskriminues duke ndërtuar vetëm kishën, apo të bëhet përjashtues, duke ndërtuar edhe xhaminë. Që të dy opcionet janë të këqija. Kur ke të zgjedhësh më pak të keqen nga dy të këqija e që të duaja kanë të bëjnë me një BËRJE, pse opcioni i MOSBËRJES, pra mosndërtimit duket aq i vështirë për ta artikuluar në një linjë normale (heretike) qytetare.

Argumentimi i të tashmes përmes reflektimit në të kaluarën dhe jo në të tashmen është manipulim. Pra, është manipulim argumentimi në kohën e tashme i të vërtetës historike në të tashmen për Shën Konstantin dhe Elenë dhe Burmalin Xhaminë. Kisha në shesh, ajo që fatkeqësisht dita ditës duket sa më e mundshme, do të ketë fatin e njëjtë si edhe 'Kryqi i Mileniumit' i ndërtuar në Vodno i cili nuk ariti të bëhet simbol i qytetit, as nuk tërhoqi turistë në 'tokën biblike', por harxhon rrymë të kushtueshme në kohë krize dhe në vend të dritës ai lëshon hije të rëndë mbi gjithë qytetin. Nëse me të vërtetë KOM-i dhe BIM-i duan të rekonstruktojnë objektet religjioze ata duhet të fokusohen në realitetin ekzistues, atë të Manastirit të djegur të Shën Jovan Bigorskit (Bigurit) dhe Xhamisë së Prilepit, që të dyja bartin shumë simbolikë të trashëgimisë kulturore, pa mos pasur nevojë të 'pjellin' ide të reja për biznes të reja.

Të gjitha këto salto mortale publike për replikim të objekteve religjioze janë thjesht replikim i praktikave mesjetare (shteti dhe religjioni) dhe kur kjo nuk has në kundërshtim të madh publik ajo paraqet simptomë të mospërjetimit të majftueshëm të mesjetës që sot i komplekson masat dhe frustron politikën. Kur të kihen parasysh të gjitha 'bizneset famoze' të KOM-it, bekimi i kryeministrit nga kryehoxha dhe marrëdhëniet e tokës mes BIM-it dhe Qeverisë, e vetmja rrygë etike që e imponon insistimi i qartë në të vërtetën reale në kohën e sotme mbetet HEREZIA QYTETARE. AMIN.

# Greva jonë është beteja për t'i rezistuar përuljes së jetës në privatizim

## Refugjatë në ishull

### Kronika nga greva e Marubit

Elton Baxhaku

Kur ti pyet nëse ka nevojë për një Kinematë apo për një Akademi filmi në Shqipëri, përgjigja është: pa tjetër që po. Vendi ynë ka nevojë për më shumë gjëra të tilla pikërisht siç është Akademia Marubi. Duhet dhënë si shembull marrëdhënia që ka kjo Akademi me të jashtëm dhe me të brendshëm. Me se korrekte me të gjithë institucionet e vendit dhe mëse e sukseshme në kompeticionet jashtë vendit.

Kombëtarë dhe ndërkombëtarë janë shumë dakord që kjo akademi është shembulli që duhet ndjekur për zhvillimin e kulturës dhe artit në Shqipëri, madje veçanërisht për ringjalljen e kinemasë në një vend me traditë kinematografike si ky i ynë. Kështu thonë të tërë. Ministri i kulturës, Ministri i ekonomisë, Kryetari i bashkisë së Tiranës etj. Të gjithë një zëri, po të kishin mundësi do të thonin: Si Marubi nuk ka.

Veçse kjo nuk është gjithçka çka thonë ata.

Personalisht të gjithë kanë respekt dhe e mbështesin shkollën Marubi. Personalisht po të kishin mundësi do të bënin çmos që të kishte qetësi tek Marubi, dhe që studentët që kanë shpallur grevë t'i ktheheshin mësimi normal. Të gjithë personalisht mendojnë se është një gabim i madh që Akademia Marubi të jetë nën sulm të vazhdueshëm.

Gjithashtu, siç tha edhe juristja e ministri së kulturës, në takimin e javës së fundit me përfaqësuesit e studentëve "ne të gjithë jemi nga pak artistë në shpirt".

Pastaj zoti Çashku mund të kërkojë privatizimin e kësaj pjese/godine që ta lemë rehat. Pra gjithçka thuhet drejtohet drejt një mundësie zgjedhje private. Vetë përfaqësuesit e shtetit shqiptar, me ministrat e tij, bashkë me pushtetin lokal, të drejtojnë tek zgjidhja private, dhe privatizuese. Problemi privatizohet, si në mënyrën e zgjidhjes ashtu dhe në mbështetjen që japin si privat çdo drejtues institucioni.



Por ka dhe një problem ligjor, na thonë. Se ne nuk mund të veprojmë kundër ligjeve. Duhet të na kuptoni. Se gjithashtu, zoti Çashku ka fyer institucionet e shtetit, dhe të bësh një gjë të tillë, institucionalisht nuk të falim. Sepse si në kohën e Komandantit historik po të flisje kundër shtetit dënohesh jo vetëm moralisht por edhe ligjërisht. daj privatizimit të kësaj çështje, ne i vëmë publikun që di të prodhojë kinemaja. Ne duam të bëjmë kinema, edhe pse shteti nuk ka dorë fare në këtë projekt, edhe pse nuk na ndihmon edhe pse në këto kushte ku gjendemi nuk ka mundësi prodhimi të mëdha. Ne po bëjmë të pamundurën për të bërë filmat tonë. Janë filma kryekëput pa buxhet. Janë prodhim shqiptar, dhe mbajnë kokën lart në çdo konkurim ndërkombëtar. Këtë kërkojmë ne, të mos na pengojmë të bëjmë këtë gjë që kemi zgjedhur. Propozimet private që vijnë nga funksionarët e lartë të shtetit tonë janë veç propozime emigrimi. Në një mënyrë apo në një tjetër të gjithë na kërkojnë të ikim që nga ky vend. Jo me mirësjellje por thjesht dhe qartë me dhunë policore.

Edhe pse të gjithë zyrtarisht janë kategorikisht kundër këtij emigrimi, sa kanë sajuar Brain Gain e Brain Stand e

të tjera të tilla si këto pranë Kryemigracionistit. Që praktikisht do të thotë se paguhen nëpunës nga buxheti kombëtar që të mos ikin si tru jashtë këtij vendi.

Ne që po bëjmë shkollimin tonë këtu, pa i kërkuar askujt asgjë ne mesa duket s'jemi të kualifikuar si TRU. Prandaj që prej një viti ne na sjellin policinë në territorin akademik, veç ne s'po e kuptojmë qartë që duhet të bëhemi refugjatë.

Kërkesat e Studentëve të Akademisë Marubi s'janë as më shumë e as më pak sesa dashuria për artin e për vendin e ato thërresim për:

Mos refugjatizim.  
Ruajtje të kinemasë.  
Ruajtje të traditës kinematografike të ish Kinostudios.

Shaqjen e një tjetër imazhi të Shqipërisë në kinematë botërore.  
Pasurimit të hapësirës jetike e publike. Kërkesat e studentëve të Akademisë Marubi janë të rendit të së drejtës njerëzore, civile e politike që janë fituar prej kohës në civilizimin ku jetojmë. Këta studentë kërkojnë: të zhvillojnë mësim jo si kafshët e egra të kopshtit zoologjik mes gardhesh e policësh privat e shtetëror por si kemi

rënë dakort për kushtin njerëzor e atë akademik në kushtet normale të jetesës në komunitet. Të mos enden në gardhe policash që parcelizojnë me kufinj fizik e tela me gjemba që të shpajnë fillimisht vetëm nga pamja por edhe fizikisht gjeri në grurrerjen e kockave. Një gjendje e tillë nuk quhet e pranueshme as për vendin me të humbur politikisht. Nuk ka guxuar askush t'u heqi të drejtën për bërë kinema studentëve. Nuk imagjinohet as në mendimet më të ndyra që mund të ketë ndonjë pushtetar. Dhe, PO, sot në Shqipëri me këto foma e formulime kjo po kërkohet.

Në "ish kinostudion shqipëria e re" të mos mbetet asnjë gjurmë e cila mund të dëshmojë diçka nga kinematografia e zhvilluar në këtë vend. Askush nuk do të mbajë më mend që këtu ka pasur një botë filmi, sepse s'ka për të pasur më studentë të kinemasë që do ta dëshmojnë këtë, me filmat e tyre. Askush nuk do të mbajë më mend pasi të jenë shkatëruar negativët e filmave që gjenden në arkivin e shtetit (në kinostudio). Gjithçka po rrezikon të fshihet sikur të mos ketë ndodhur asgjë. Do harrohet që kemi pasur

garderobë e rekuizitë të jashtëzakonshme. Tashmë të gjitha të vjedhura.

Gjithçka e shkatëruar dhe e vjedhur. Ose në forma më makabre, ose të lëna në mëshirë të fatit deri sa një ditë t'u bie tavani dhe te të vidhen, pra të bëhen prona private. Nuk numërohen sa stacione televizive janë ndërtuar këtu në kinostudio. U zbrazen të gjitha atelieret e dikurshme të filmit, u prishën dhe mbi to ndërtuan masivë betoni për të dhënë spektaklin e rradhës për të shkatëruar dhe atë pak shije estetike të publikut shqiptar.

Mirë që televizionet bënë punën e tyre, të privatizimit, por ashtu si ulkonjat lavazhot dhe fushat e kalçetos kanë marrë nga një copë sipas dëshirës, duke ngushtuar përditë e më shumë hapësirën jetike për një kinematografi. Unë ju propozoj një Promenadë në kinostudio, në studiot e kinos, beton, beton dhe vetëm beton. Të ecim përpara drejt betonizimit, edhe për ato pak metra katror që kanë mbetur pa u betonizuar dhe të biem rehat pastaj. Mbase do të ketë punë për të prishur disa nga këto betone që të mbjellin ndonjë pemë, por kjo është ëndërr e largët.

Gjendja është e mjerueshme. Por fundja ky vend është mësuar me jetesën në batak.

Veç NE jo. Ne JO.

Ndërkohë që kretje e kundërta ndodh tek Marubi. Kryekëput e kundërta. As shkatërrim, e as ndryshim destinacioni. Shfaqje filmash e salla kinemaje. Prodhim filmash. Leksione Kamere e fotografie. Leksione Regjie. Leksioni Skenari. Leksione Estetike e Filozofie. Pesë vjet jetë Akademia Marubi, pesë çmime për filmat tanë në festivalet ndërkombëtare.

Pra, po ta shohësh tamam tamam Marubi i ka të gjitha arsyet për të MOS qenë aty ku është, me këtë formë që ka, dhe me të gjithë teroret funksionale. Sepse Marubi është e kundërta totale e vjedhjes së vendit tënd, e mohimit të çdo të shkuare dhe anulimit të çdo të ardhmeje. Marubi është në fakt mundësia e një ndërgjegje që ende s'është në Shqipëri. Prandaj çdo funksionar sapo sheh Marubitë duket në fytyrë vështirësia e frymarrjes pikërisht ashtu si na zihet frymarrja kur ka shumë oksigjen. Marubi është në Grevë. Greva jonë është thirrja dhe vendimi për të mos ta lëshuar vendin tonë, është thirrja për t'a pasuruar me emër shqiptar listën e filmit. Greva jonë është beteja për t'i rezistuar përuljes së jetës në privatizim. Greva jonë është shenja e sëmundjes që nuk po e lëshon këtë vend dhe po ia largon çdo ditë përpjekjen për të parë atë si vendi i projektimit të ëndrrës, të drejtë të cilën e kemi nga vetja e s'ia kemi borxh askujt.

Qëndresa MARUBI vazhdon...



Besnik Pula\*

Problemi në Kosovë nuk është mosfunksionimi i gjykatave dhe i sistemit penal

# Për kë punon (dhe për kë jo) sistemi i drejtësisë?

Korrupsioni është padyshim një nga temat kryesore të debatit publik, kurse një prej shkaqeve të përfolura për mosndaljen e korrupsionit është, siç thuhet shpesh, mosefikasiteti i sistemit të drejtësisë, në veçanti të prokurorëve dhe gjykatësve, në ngritjen e akuzave dhe dënimit penal të rasteve të mëdha të korrupsionit.

Mungesa e rasteve të gjykitimit kundër afërave korruptive në qeveri dhe në administratë, përkundër shumëfishimit të instancave dhe zyrave qeveritare të angazhuara në luftë kundër korrupsionit, përkundër indikacioneve të qarta dhe të dokumentuara të keqpërdorimit të fondeve publike, shpesh ka çuar gazetarë, komentatorë mediale, por edhe qytetarë të rëndomtë, në përfundimin se një nga problemet themelore në Kosovë është mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë në luftimin e korrupsionit. Përshtypja është që në Kosovë nuk funksionin sistemi i drejtësisë, se korrupsioni shtrihet edhe brenda sistemit penal, se hetuesia, prokurorët dhe gjykatësit janë goftë vetë të implikuar në korrupsion, goftë të kërcënuar e të shantazhuar që të mos ndër marrin asnjë gjykim të profilit të lartë kundër bosëve të lartë politikë në qeveri.

Një gjë të tillë e vërtetojnë burime të ndryshme që kanë analizuar nga afër punën e sistemit të drejtësisë në Kosovë. Kritika drejt sistemit të drejtësisë i ka drejtuar Raporti i fundit i Këshillit Evropian, i cili konsideron se prokuroria dhe gjykatat janë pamjaftueshëm të angazhuara në luftë kundër korrupsionit. Sipas një raporti mbi sistemin e drejtësisë të hartuar nga organizata Çohu vitin e kaluar, Agjensioni Kosovë Kundër Korrupsionit (AKKK) gjithashtu ka nënvizuar sistemin gjyqësor si një nga resorët me numrin më të madh të rasteve të dyshuara të korrupsionit, pas qeverisë, për vitin 2008. Në raportin e fundit (2009), sipas AKKK sistemi gjyqësor tejkalon edhe qeverinë me raste të raportuara të korrupsionit.

Por, megjithëse është e vërtetë se sistemi i drejtësisë, edhe pse nën administrimin e pjeshëm të EULEX-it, nuk ka ndërmarrë deri më tani asnjë rast masë penale kundër çfarëdo zyrtari të lartë kundër korrupsionit, a është e saktë të thuhet se në Kosovë kemi të bëjmë me një sistem të drejtësisë totalisht joefektiv? Siç dihet, si nga UNMIK, tani edhe nga EULEX-i, sistemi penal ka qenë një nga prioritetet e investimit institucional në Kosovë, madje në shkallë më të lartë ndoshta se çfarëdo sektori tjetër i administratës shtetërore. Policia e Kosovës shpesh është marrë nga institucionet ndërkombëtare si model për rajonin; janë bërë investime në modernizimin e gjykatave dhe burgjeve, si dhe në trajnimin e prokurorëve dhe gjykatësve. Ku shihen efektet e këtij investimi?

Në fakt, sistemi i drejtësisë në Kosovë ka shënuar shkallë të theksuar rritjeje të efikasitetit në vitet e fundit. Pyetja është, ku është ndërjer kjo rritje e kapaciteteve, apo më saktësisht, cilat segmente të shoqërisë e kanë ndërjer këtë rritje të efikasitetit në sistemin penal dhe gjyqësor? Ashiqare, kjo rritje e efikasitetit (me përjashtim të rasteve, patjetër të motivuara politikisht, të gjykimeve kundër ish-pjesëtarëve të UÇK-së për krime të bëra para dhe gjatë luftës), deri më tani nuk ka prekur njerëzit në pushtet, njerëzit me lidhje me njerëzit e pushtetit, dhe të tjerë të kësaj kategorie sociale.

Për çfarë rritje të efikasitetit është fjala? Në fakt, statistikat zyrtare na bëjnë të njohur se në vitin 2003 janë zhvilluar 4.870 dënime për pena-

le në gjykatat komunale (duke përfshirë të miturit), ndërsa në vitin 2007 ky numër ka arritur në 11.096, domethënë për katër vjet kemi të bëjmë gati me një trefishim të numrit të të dënuarve! Jo vetëm kaq, por nëse llogarisim numrin e dënimeve (fjala është gjithmonë për dënime për ato raste që Kodi Penal i Kosovës i përkufizon si krime penale, jo për dënime për kundërvajtje, nga të cilat ka pasur mbi 130.000 raste në gjykata), del se numri i dënuarve penal në Kosovë (nëse supozojmë një popullsi, sipas vlerësimeve të Entit Statistikor të Kosovës, prej 2.100.000 banorë në vitin 2007) është 528 për çdo 100.000 banorë, shkallë që nuk është e vogël.

Shifra e të dënuarve nuk ka rënë as për vitin 2008, që është viti i fundit për të cilin janë botuar të dhënat. Të dënuar në Gjykatat Komunale gjatë këtij viti kanë qenë 10.785, ndërsa 1.687 nga Gjykatat e Qarkut. Rreth 70 për qind të rasteve në Gjykatat Komunale përfundojnë në aktgjykim dënues; për Gjykatat e Qarkut ky numër rritet në 85 për qind të rasteve. Pra në pjesën më të madhe, rastet që dalin para gjykatave përfundojnë në dënime. Ajo çka përbën interes është struktura e dënimeve të shqiptuara gjatë këtij viti, që tregon mjaft se çfarë lloji krimesh dhe, rrjedhimisht, cilat segmente shoqërore (meqë lloji i kriminalitetit lidhet ngushtë me pozicionin shoqëror) janë në shënjestër të sistemit penal në Kosovë.

Pas qëndrimit të tij në burg gjatë vitit 2007,

Albin Kurti në disa deklarime publike pat treguar se çfarë profili kriminelesh ka takuar nëpër burgjet e Kosovës. Sipas tij, aty nuk kishte takuar ish-zyrtarë, politikanë, menaxherë të ndërmarrjeve, bankierë, e as biznesmenë të mëdhej. Aty kishte takuar kriminelë ordinerë, ndonjë hajn që ka vjedh 100 euro nga arka e ndonjë minimarketit, ndonjë fallsifikator dokumentesh, e të tillë. Kjo përshkrimi personale e Albinit e krijuar gjatë frekuentimit të tij të detyruar në burgjet e Kosovës, reflekton edhe në strukturën e krimeve të dënuara nga gjykatat. Rastet më të shumta janë të dhunës personale (mbi 1000 raste), kërcënimeve (afër 500 raste), fallsifikime dokumentesh (mbi 1000 raste), veprim kundër rendit publik (mbi 2000 raste) dhe mbi të gjitha vjedhje (mbi 3000 raste, afër 4000 nëse përfshihen edhe rastet e vjedhjeve të pyjeve). Mbi 96 për qind të të dënuarve janë meshkuj. Kjo nuk nënkupton ndonjë mbrojtje të veçantë ligjore për femrat, sepse në vitin 2008 vetëm një rast dënimi (!) ekziston për dhunim seksual.

Gjithë këto fakte tregojnë se nuk është e saktë të thuhet se sistemi i drejtësisë në Kosovë nuk funksionon. Ai funksionon relativisht mirë, por funksionon vetëm për disa: hajnat e vegjël, mashtruesit e ndryshëm, fallsifikatorët, meshkuj që kapen në akte të dhunës ndërpersonale – të gjithë, mund të supozojmë kollaj, të rinjë, të papunë, të shtyrë në krim nga nevojat për sigurimin e ekzistencës dhe mungesa e oportuniteteve për avancim legjitim shoqëror dhe ekonomik. Por,

përderisa pjesa më e madhe e përndjekjeve penale drejtohen në këto raste dhe ndaj kësaj kategorie shoqërore, duhet theksuar se në vitin 2008 ka pasë përndjekje penale edhe kundër abuzuesve të detyrës zyrtare: 72 raste, ndërsa katër prej tyre kanë përfunduar në dënime relativisht të larta, prej 2-5 vjet. Por këto rubrika sikur duhej të dukeshin më të plota në ditët e sotme, të paktën sipas atyre që na tregojnë AKKK, mediat dhe organizatat joqeveritare që merren me dokumentimin e korrupsionit. Aq më pak kur nga këto 72 raste, nuk kemi dëgjuar për ndonjërin të ketë qenë nga qeveria apo administrata e lartë e shtetit, pra sipas të gjitha gjasave kemi të bëjmë me nëpunës të ulët të administratës apo të nivelit komunal.

Sidoqoftë, ajo që është e qartë është që përfundimisht, problemi në Kosovë nuk është mosfunksionimi i gjykatave dhe i sistemit penal. Problemi është, dhe vazhdon të jetë, çështja se ku janë orientuar prioritetet dhe mjetet e sistemit të drejtësisë. Ai sot merret kryesisht me llojet e kriminalitetit që janë pasojë e krizës sociale në Kosovë, pra një aparat shtetëror i drejtuar në radhë të parë kundër të varfërve dhe të marginalizuara të shoqërisë, përderisa krimet më të mëdha të këtij vendi jo vetëm kalojnë pa u dënuar, por shpërblehen në të gjitha aspektet. Për këtë imunitet juridik dhe politik që gëzon krimi i lartë në Kosovë, ndër të tjera, padyshim se duhet t'i shprehim mirënjohjet tona edhe EULEX-it.

\*Sociolog - www.besnikpula.com



Darien Levani


Jetojmë kohën që jetojmë dhe kush dëshiron tashmë e ka kuptuar : ajo që shet më shumë nuk është cilësia e një prodhimi/shërbimi por mënyra se si ky të ofrohet. Deri këtu asgjë e re nën diell : në blejmë, ata gjejnë mënyra të reja reklamimi për tu futur në kokën tonë, në bindemi e vazhdojmë të bëjmë punë që nuk na pëlqejnë për të blerë gjëra që nuk na duhen e të tjera e të tjera. Ndryshimi thelbësor me duket se është ky ; që nëse në të kaluarën konsumimi ishte thjesht një njet me të cilin mund të përmirësojë jetën tënde duke blerë gjëra materiale, sot konsumimi është bërë vetë jeta jote. Të konsumosh s'është më mënyrë për të arritur diçka, por është vetë diçkaja që dëshiron të arrijsh. Produkti zëvendëson nevojshmërinë e tij, thjesht kaq. Nuk është për tu habitur pra fakti që shumë nga reklamat e sotme s'kanë të bëjnë aq shumë me cilësinë e produktit në fjalë sa me faktin që shumë njerëz të tjerë kanë përdorur të njëjtin produkt. Këtu qëndron edhe magjia e zezë e shpirtit tregtar, duke qënë se reklamat arrijnë në një farë mënyrë të të bindin që duke blerë një produkt që përdoret nga masa, ti do tregosh se je unik. Mendoj për kompjuterin tim, që ndonjë gjëni komunikimi ka quajtur personal computer. Personal, pra i imi. E s'ka gjë që në botë ekzistojnë edhe ca mijëra të tjerë identik, janë të gjithë personal.

Në këtë pikë, si shumë faktorë të tjerë, edhe provincializmi ka pjesën e tij të fajt. Keqkuptimi lind më së shumti nga fakti që me sa duket rrënja e fjalës "provincializëm" është tamam "provincë", fjalë që sipas fjalorit tregon një zonë "larg kryeqytetit, zakonisht e prapambetur (për vendet e tjera)". Dakord deri këtu, po të mos ishte kjo drejt "për vendet e tjera". Tani, s'besoj se më duhet të harxhoj ndonjë rresht më shumë për të thënë që çdo gjë është provincë e ndonjë gjeje tjetër, e kjo e fundit provincë e diçkaje tjetër. Sidomos sot kur psh gjithmonë e më shumë e njëjta borgjezi që kishte lënë fshatin për të theme-luar qytetin nuk po e pëlqen më dhe po kthehet në fshat i cili nga provincë bëhet qendër ndërsa qyteti bëhet provincë e kështu me radhë. Ka një rivlerësim, edhe të rizbulimi i provincializmit vintage në rroba e fotografi të vjetra. Provincializmi, të paktën në mënyrë sipërfaqësore, nuk është aq shumë prapambetje kulturore, sa është prapambetje sociale e psikologjike. Unë mund të mburrem me faktin që " jam shumë cool meqë banoj mrena unazës" deri në pikën në të cilën bashkëfolësit e mi janë të gatshëm t'a pranojnë këtë fakt si provë të aftësisë sime. Provincializmi nuk jam unë në raport me ta, por ata në raport me mua. Kështu që prov. më i shfrenuar nuk është ai që jeton në skajet e filan shteti, por ai që jeton në skajet e mendjes së filan personi i cili beson se vetëm një rastësi gjeografike njafton për të justifikuar superioritetin tim.

Si në shumë sporte të tjera, edhe në këtë kam përshtypjen që në shqiptarët nuk jemi keq.

Brenda mundësive së kohës – e sidomos së xhepit – ndjek gjithmonë me interes forma të ndryshme arti, sa në atdhe aq edhe jashtë. Dhe mund t'ju them me bindje të plotë që në Shqipëri kam parë e vazhdoj të shoh ekspozime të kryera nga artistë të huaj që marrin një vëmendje të jashtëzakonshme, më të madhe se sa ajo që ( duhet të ) marrin shqiptarët ( bëhet fjale, gjithmonë, kur kanë të njëjtin vlerë). Lajmet p.sh kur flasin mbi këto e nisnin zakonisht kështu " Ai është një artist amerikan i cili jeton në Manhattan e ndodhet në Tiranë për të prezantuar bla bla blane e tij të fundit..."

Ndodh e njëjti fenomen edhe me shqiptarët që jetojnë jashtë në krahasim me ata që jetojnë brenda. Këta të dytë mund të bëjnë një mijë gjëra, e do kalojnë gjithmonë pak si nën ro-



# Mbi provincializmin e pak tema të tjera (reklama, snobizëm, art )

goz ndërsa të dytë, thjesht për faktin që vijnë nga Roma, Parisi a Berlina trumbetohen edhe vetëm për një vepër, çoftë kjo piktura, këngë, çka drejtin të doni. Ka një deformim që mund të quajmë "koeficient gjeografik". Nga një anë, një shumëzim për njëmijë. S'është e drejtë.

Nuk më intereson në këtë pikë të përmend as emra e as mbiemra, kështu që nëse jeni në pritje të këtyre edhe mund të ndërroni faqe. Ajo që heroikisht denoncohet në këto shënime është një mënyrë konceptimi përtej rasteve konkrete. E këtu hyn në lojë edhe reklama për të cilën po ju flisja më sipër. Ka një formulë që përdoret rëndomtë nëpër promovime, e tingëllon kështu " Dhe tani për ju, me turin e tij që ka prekur qytete si Madridi, New York, Barcelonë e Milano, vjen në Tiranë Filan Fisteku..." apo " Libri bestseller në Amerikë, Angli e Francë, më në fund përkthyer në shqip, Filan Fisteku me librin e tij Bla bla bla."

Asnjë nga këto reklama nuk thotë vetëm atë që lexojmë, mesazhi i vërtetë në fakt është pak më i fshehur. Po, në mësojmë që artisti paska qënë në Milano e nesër do shkojë në Berlin, por neve aq na bën për tu informuar mbi itinerarin e tij. Ajo që në fakt dëgjojmë është " Shikoni se ky njeri që po ju sjellim është nga ata që xhiron kudo, që e kanë vlerësuar në gjithë botën që merr vesh nga vlerësimet, e kështu që nëse dëshironi të mos braktiseni në atë Shqipëri/Tiranë tuaj të vogël, edhe ju keni mundësi të futeni në këtë vorbull, me kush që të blihi biletën/diskun/librin, e në nuk do ju lëmë mbra-pa..." Ndodh që gjeografia zëvendëson njeriun

e detyrimisht edhe forma zëvendëson përmbajtjen. Është një fare snobizmi mbrapsht.

Pse Darien pse, të lutem na trego se pse?

Pse ndodh kjo? Nga ta nis e nga ta lë? Nga një anë (sh)freminimi komunist – s'jemi në sot nipër a fëmijë të atyre që dëgjonin fshehurazi artistë tip Çelentano e festivale tip Sanremo? – sollni në fillimin e viteve 90 fenomenin e vetëm që mund të sillte: një rivlerësim të të gjitha vlerave tona artistike e një mbivlerësim të gjithçkaje që arrinte nga përtej kufijve kombëtarë. Këto janë ca gjëra të cilat nuk mund ti kontrollosh e ja që rivlerësimi i virtyeteve tona në fakt ishte ajo që teknikisht quhet "fundosje", e sa më e madhe e e ashpër që kjo, simetrikisht aq e lartë ishte "vlera" e "gjërave të jashtme". Jemi akoma në të njëjtin proces, edhe pse kemi ecur ndonjë hap para. Tani, s'është e thënë të jetë detyrimisht diçka e keqe, duke qënë se në fund të fundit kurioziteti është një ndër motorët që lëviz jetën tone. Pa kuriozitetin e një qyteti, të një libri a njeriu të ri nuk do kishte njohje, ndryshim e konflikt. E në vitin 1990 në nuk ishim thjesht kurioz, ishim të etur e të tharë. S'ka rëndësi se për çfarë : rroba, çokollata, gazeta, çunçakiza a fjalë të huaja. Për më tepër, ndryshe nga popujt fqinj, nuk kishim zhvilluar akoma antikorpe të denjë për të filtruar reklamat e dëmshme. Në vitet 90 pak televizione të huaj do guxonin ti servirin publikut të tyre reklama si " KRONENBURG" apo ku e di unë, " TOP-HAT". Ne jo, në donim të na tregonin mënyrën amerikane të jetës pa pasur as mundësinë e as aftësinë ta analizonim. S'ndryshon shumë, besoj që edhe po të kishim këto (anti-

korpet) do ndryshonte pak fare, e për atë "pak fare" po flasim. Të paktën mund të kishim evituar tipa si Gazebo në festivalin tonë të këngës, apo një italian tjetër ( Festivali i Këngës 2007 apo 2008 ) që ishte i famshëm sepse paskësh qënë mik i Gian Maria Volonté, një tip që për publikun shqiptar është i famshëm se ka bërë ata filmat me sherifa bashkë me Clint Eastwood. Në përgjithësi Eastwood e vret nga fundi i filmit.

Arsye të tjera? Mund të ketë edhe arsye të tjera, po është e kotë të zgjatem. Në fund të fundit, të gjitha këto janë vetëm mënyra më të lakuara për të thënë të vërtetën : që jemi provincë e Ballkanit që është provincë e Evropës. Nëse duam vërtet të nisim një rrugë të gjatë për të rikëmbur kulturën tonë duhet të nisemi duke e pasur gjithmonë në mendje këtë të vërtetë.

Ka një mënyrë matematike për të verifikuar këtë, e janë artikujt e shumtë që qarkullojnë lart e poshtë e vazhdojnë të pohojnë rëndomtë që nuk jemi të tillë. Ndonjëherë, hapi i pare drejt rrëfimit të fajt është mohimi i tij. Askush nëpër qytet e rëndësishtme nuk krijon një debat ku pyet nëse janë bërë provincial apo jo përjashtojnë ndonjë diskutim underground shkrihtarësh prepostpost modern të mërziutur ) . Nga një anë sepse nuk kanë nevojë për diskutime sterile, e, nga ana tjetër, meqë e dinë mirë që nuk janë të tillë. Edhe e dinë që s'janë të tillë sepse nuk e pohojnë që janë të tillë. E kundërta e asaj që ndodh këtej nga ne, ku, fakti që me argumente patetike pohohet që nuk jemi provincial = detyrimisht s'do jemi të tillë. Por në momentin e saktë në të cilin justifikon jo prov. tënde, ai është edhe momenti në të cilin e konfirmon.

Brenda një sistemi që funksionon nëpërmjet kësaj ideologjie mpirëse, qytetari nuk është asgjë

# Vakumi ideologjik si kriter për rimëkëmbjen e nacionalizmit

Me mbarimin e luftës së dytë botërore dhe gradualisht me ngri-tjen e perdes së hekurt kontinenti evropian u bë subjekt i një rreshti-mi komunizëm-kapitalizëm po aq sa lindje-perëndim. Praktikisht vetë ekzistenca e një dualizmi të tillë midis dy ideologjish konkurruese - ashtu siç dhe historia tregoi - më shumë sesa favorizonte kapitalizmin u shndërrua në një faktor që do të gërryente përbrenda modelin komunist sovjetik. Në njëfarë mënyre, komunizmi sovjetik duke u kthyer në një regjim konkurrent, duket sikur ishte përfshirë në mekanizmat e brendshëm të sistemit kapitalist imperialist. 20 vjet pas rënies së komunizmit dhe të perdes së hekurt, sot Europa gjendet në kuadrin e një tendence masive çideologjizimi. Fakt ky i cili shpjegohet me transformimin e kapitalizmit në një sistem global, të importueshëm, të eksportueshëm, të panegociueshëm por mbi të gjitha të pakundërshtueshëm. Situata ka arritur deri në atë pikë sa që edhe vetë ideologjia sotme duket si një diçka që mund ta kesh ose të mos e kesh; mund të bësh sikur e ke por që në fakt të mos e kesh; apo ta kesh (në kuptimin e plotë të fjalës) dhe ta perdorësh vetëm atje ku duhet. Gjithsesi, përtej këtyre dilemave post-moderne, ky shkrim synon të trajtojë këtë tendencë masive çideologjizimi në shoqëritë e sotme dhe format e reja të shpërndarjes së ideologjisë në superstrukturat shtetërore.

Pikësëpari duhet shpjeguar se kjo ideologji (e prezumuar si e tillë) tradicionalisht ka qenë e ushtruar nga ana e elitave përfaqësuese, madje edhe në vëndet e njohura botërisht si jo-demokratike, në rastin më të keq ka qenë ideologjia me sfond fetar ajo që ka luajtur rolin e ideologjisë sunduese. Por çfarë funksioni ka kjo ideologji në fakt?

Mund të thuhet se funksioni primar i ideologjisë është materializimi i idesë se qeverisësi (qoftë ky kryeministër, mbret apo despot) ka njëfarë legjitimiteti për postin e tij.

Një rast të veçantë në këtë drejtim përbëjnë juntat ushtarake në Amerikën latine apo regjimet despotike në Haiti, Republikën Domenikane dhe Nikaragua që qeverisen përgjatë pjesës më të madhe të shekullit të kaluar, legjitimiteti i të cilave nuk vinitë si rrjedhojë e ndonjë qasjeje



ideologjike domethënëse. Në këto lloj regjimesh liderët nuk vinin si pasojë e ideologjisë, por përkundrazi ishte ideologjia ajo që propagandohej si pasojë e ekzistencës së liderit. Arsyeja e kësaj ishte se këto regjime nuk kishin ndonjë nevojë të madhe për t'u legjitimuar ndaj popullit të tyre, sepse kryesisht legjitimiteti i tyre vinte nga mbështetja e ndër-kombëtareve. Por ajo që është më domethënëse është fakti se edhe në këto regjime të njohura botërisht si despotike, udhëheqësi pas marrjes së pushtetit, ushtronte një lloj ideologjie, pavarësisht nga tiparet e kësaj të fundit.

Në të kundërt, në demokracitë e sotme neoliberale pretendohet se shkalla e demokracisë është aq e lartë sa që tashmë ideologjia dhe nocione të tilla "të prapambetura" si e majta dhe e djathta janë të tejkaluara.

Ky moment është tregues i një fakti tepër të rëndësishëm të këtyre 20 vjetëve të fundit: Demokracia kapitaliste e fuqizuar nga konkurrenca e pasluftës së dytë botërore nën siglën "e keqja

më e vogël", tashmë ka arritur një stad që nuk i mbetet veçse të konkurrojë me vetveten. Tashmë nuk kemi më një konkurrencë mes të majtës dhe së djathtës por mes çideologjizimit dhe ideologjizimit të aparatit shtetëror. Dy gjëra pra që është e nevojshme të konceptohen si të ndryshme pavarësisht se realisht janë të njëjta. Në fund të fundit edhe vetë çideologjizimi është faktor i një ideologjie të re në politikën përfaqësuese, sepse është e kuptueshme që për aq kohë sa kemi përfaqësim normalisht do të kemi edhe një ideologji e legjitimiton këtë përfaqësim. Në rastin konkret bëhet fjalë për një formë të re ideologjie, të cilën e transmeton imazhi thjesht nga prania e tij si i tillë.

Çdo formë regjimi për legjitimimin e tij ka nevojë që në rripat si mediat, institucionet, shkollat, drejtësia etj. të filtrohet ideologjia e tij sunduese. Është ajo çka Althusseri e quante "Aparati Ideologjik Shtetëror", pa të cilin një qeverisje nuk mund të legjitimohet tek të qeverisurit. Fakti që gjatë fillimit

të këtij shekulli politikati "përtej së majtës dhe të djathtës" janë duke u trumbetuar gjithnjë më shumë nuk tregon se bota ka arritur një nivel zhvillimi post-ideologjik, por përkundrazi që regjimi ekzistues nuk ka më nevojë për kurrfarë mjeti për t'u legjitimuar. Pra që thjesht ekzistenca e tij mjafton për ta legjitimuar këtë sistem si të tillë. E gjithë kjo shoqërohet me synimin për ta bërë individin sa më të tërhequr dhe pasiv. Një qenie amorfe që nuk ka nevojë të mendojë është metoda më e mirë për ta totalizuar sa më tepër pushtetin, dhe me në sfond tullumbacet me ngjyra berluskoniane të harmonizuara me velinat gjysmë lakuriq arrihet dhe qëllimi final për ta bërë individin të ndjehet sa më komod në pasivitetin e tij. Për pasojë sot fare mirë mund të flasim për një politikë post-arsye, ku individit i lejohet të arsyetojë vetëm "atje ku duhet". Madje edhe vetë sasia e informacionit që i përçohet këtij individit është kthyer në një mall tregu, ku sa më i thjeshtuar të jepet aq më i tregtueshëm bëhet. Ashtu sikurse edhe vetë indivi-

di nuk është më qytetar por një klient i vazhdueshëm duke shkruar nga një sipërmarrës në tjetrin. Individit tashmë është shndërruar në një klient të përhershëm në çdo sferë të jetës së tij, ndërkohë që sipërmarrësit gjenden kudo: në universitet, në sport, në informacion, në art, në seks por mbi të gjitha në shtet, asetet e të cilit vit pas viti po i nënshtrohen një fushate privatizimi gjithnjë më të ashpër.

Në lidhje me shoqëritë moderne, Herbert Marcuse thekson: "Në këtë tendencë të re, funksioni i natyrës mitike, parahistorike është të shërbejë si kundërshtar real për praktikën racionale të paruarur e të përgjegjshme. Si diçka që justifikohet thjesht nëpërmjet ekzistencës, kjo natyrë qëndron kundër gjithçkaje që i shndërrohet këndvështrimi historik. Ajo çka gjendet poshtë arsyes e ngre veten përmes funksionit "përtej së mirës dhe së keqes" në diçka që e tejkalon arsyen." Në momentin që pushteti justifikohet thjesht nëpërmjet ekzistencës së tij, qeverisësi i largohet më tej funksionit publik sepse në vetvete qeverisja nuk ka

# Lajmet

KORÇE POGRADEC BERAT FIER KAVAJE PUKE

# skicë

nga blendi salaj

TIRANË DURRES SARANDE VLORE SHKODER LEZH  
GJIROKASTER PERMET ELBASAN KRUIE KUKES

**HISTORIA ËSHTË E DESTINUAR TË PËRSËRITET, RAPORTON BURRI QË DËRDHI GROSHËT NË PANTALLONA**

**PËRMET**—Pasi derdhi një lugë të nxehtë fasulesh në prehër gjatë drekës, 41 vjeçari nga përmeti, Gavrosh Pllaçia e quajti aksidentin si një tjetër shembull të mënyrës sesi historia është e destinuar të përsëritet. “Njerëzimi nuk vë mend!” - foli ngadalë dhe mendueshëm zoti Pllaçia me sytë e përhumur diku jashtë dritares. “Gjizë, oriz, salcë domatesh, vaj ulliri - oh sa të paudhë jemi treguar ne njerëzit. Me çfarë vallë nuk i kemi bërë pantallonat pis? Dhe tani njerëzimi derdh fasulet!”. Sipas burimeve pranë z. Gavrosh Pllaçia, në të kaluarën ai ka theksuar se derdha në prehër e sallatës ruse është shembull i karakterit mizor të jetës. Ndërsa derdhen e pijeve, Gavroshi e sheh si shembull të ekuilibrit të brishtë midis rregullit dhe kaosit.

**XHEMAL ÇELIKU ËSHTË NË TË VËRTETË NJERI I DOBËT, NUK MUND TË JETË SKRAPALLI I VËRTETË**

**SKRAPAR**—Shefi i sektorit të novacionit në firmën elektronike skrapallie Skrapar Global Softëare, Xhemal Çeliku u tegua njeri i dobët dhe pa karakter kur në mes të të gjithë kolektivit pshehtëu thellë dhe tha se ishte shumë i lodhur. Pikërisht atëherë kur Skrapar Global Softëare kishte nevojë më shumë se kurrë për forcën udhëheqëse dhe integritetin e Xhemalit, ky i fundit tregoi se është i butë dhe i squllët. “Dua të mbarojmë në pesë sot se e kam plakun në shtratin e vdekjes në shtëpi dhe djali theu këmbën dje” - tha Xhemal Çeliku pa marrë parasysh që detyra e tij si shef është të mbajë lart moralin e kompanisë skrapalleshë të elektronikës. Vdekja e nënës dy muaj më parë dhe arratisja nga shtëpia e bashkëshortes e kanë zbëhur figurën e Xhemalit si njeri i fortë në kompani, dhe kanë zbuluar se ai është një njeri i brishtë. “Ka mundësi që Xhemali të mos jetë skrapalli. I vdiq nëna, e la gruaje, tani po i vdes plakun, djali i ka thyer këmbën, po ky bën sikur çka e gjetur. Avash mo avash... Nuk do jetë skrapalli ky.” - thotë i zhgënjyer vartësi i tij, Artan Qypri.

**MINISTRI RULI NJOFTON DIXHITALIZIMIN E PRODUKTEVE USHQIMORE**

**TIRANË**—Pas dixhitalizimit të regjistrimit të popullsisë dhe sistemit të adresave edhe Ministria e Bujqësisë ka njoftuar gjatë paradites së djeshme planet e saj për dixhitalizimin e ushqimit brenda vitit 2011. Ministri Genc Ruli, në konferencën për shtyp të mbajtur me këtë rast tha se “Brenda gjashtë muajit të parë të vitit 2011 të gjitha mallrat ushqimore që tregtohen në vend duhet të kenë arritur standardin dixhital.” “Ushqimet dixhitale janë High Definition, ofrojnë shije më të mirë, nuk kanë nevojë për punën e fermerëve pasi mund të krijohen me fotoshop. Mbi të gjitha ushqimet dixhitale nuk kanë afat skadence.” theksoi ministri Ruli. Pas afatit të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, në Shqipëri do të ndalohej tregtimi dhe konsumimi i ushqimeve të prodhuara në mënyrën e vjetër. Në mbledhjen e rradhës Qeveria Berisha do të njoftojë nismën që parashikon që të gjitha ushqimet të jenë të lidhura me internetin brenda këtij mandati.

**PALLTOJA E KOPSITUR GABIM BËN BURRIN NORMAL TË TRANSFORMOHET NË PSIKOPAT**

**TIRANË**—Pasi mbërtheu pa dashje njërin nga kopsat e palltos në vrimën e gabuar të hënën në mëngjes duke bërë që 12 centimetra të vareshin shëmtuar nga krahu i djathtë, avokati 42 vjeçar Rland Mema u transformua nga një njeri krejt normal në një idiot të vërtetë rrugësh. Z. Mema nuk e vuri re gabimin dhe mbërriti në zyrë i çartafillosur nga kopsitja e gabuar duke shkaktuar panik dhe përshqetillim me kolegëve. “Mendimi i parë që më erdhi në mendje kur e pashë ishte, kush është ky psikopat që na ka hyrë në zyrë.” - thotë Përpamir Prapthi, koleg dhe mik i vjetër i zotit Mema. “Ajo gunga që i ishte bërë në mes të palltos mu duk si bombë. Qyqja thash, na erdhi kamikazi në zyrë.” Me të shkopsitur pallton, psikopati u kthye në identitetin e tij si Roland Mema, dhe kolegët u ndien të lehtësuar.

**34 VJEÇARJA NDIHET E PREKUR NGA TEKSTI I KËNGËS QË JOE COCKER SHKRUAJTI PËR TU TALLUR**

**TIRANË**—Sekretarja 34 vjeçare, Majlinda Skandallozi e punësuar pranë një firme ndërtimi në Tiranë, tregon për klubin e mëngjesit se ndihet shumë e prekur sa herë dëgjon këngën “You are so beautiful”, të cilën Joe Cocker e këndoi për të tallur menderen me ish të dashurën e tij në vitin 1974. “O zot, sa herë e dëgjoj këtë këngë më rrënqethet mishi. Çfarë ndjenjash për këngën. Çfarë ndjeshmërie” - thotë zonjusha Skandallozi për këngën, teksti i së cilës është shkruar me ironi për një femër me të cilën Joe Cocker fjeti vetëm një natë. “Kur e luajmë këtë këngë në Club FM më mbushen sytë me lotë. Prandaj e besoj se ekziston dashuria e vërtetë, dhe se ka burra në këtë botë që dinë ta vlerësojnë një grua.” - thotë Majlinda Skandallozi për këngën “You are so beautiful”, ideja për të cilën Joe Cocker-it i erdhi ndërsa qëndronte ulur në nevojtoaren e tij në Londër.

**STUDIMI TREGON SE SHQIPTARËT KANË AFTËSITË TË JASHTË-ZAKONSHME PËR TU ZHYTUR NË BORXHE**

**TIRANË**—Një studim i ri i kryer nga ekspertë të ministrisë së financave lavdëroi të hënën aftësinë e shoqërisë shqiptare për t'i shtrirë këmbët më shumë nga çka kanë jorganin duke u zhytur kështu në borxhe të thella. “Aftësia borxh-akumuluese e shoqërisë sonë është mahnitëse” - ishte përfundimi i ekspertëve të cilët sollën si shembuj të këtij fenomeni listat e veresiveve nëpër dyqane, kreditë e pashlyera të individëve dhe bizneseve të mëdha, si edhe borxhet me interes të lartë ku qeveria ka zhytur financat e vendit. “Shqiptarët kanë bërë hapat e mëdha përpara këta njëzet vjetë, duke treguar se dinë të futen në borxhe pa fund pa e vrarë mendjen fare sesi do t'i shlyejnë ato.” - shtoi Kamat Papagurja, udhëheqës i studimit. “Janë të rralla kombet sot në botë që arrijnë të jetojnë me borxhe, le më pastaj të kenë rritje ekonomike pa prodhuar e pa punuar, siç bëjmë ne. Na lumtë... pupushka.” - përfundoi ai.

si të jetë më publike. E majta dhe e djathta nuk dallohen më për nga strategjitë e ndryshme të karakterit politik si për shembull identifikimi në grupe të ndryshme sociale, mënyrat e taksimit, argumentet pro dhe kundër anëtarësimit në organizata mbi-kombëtare, por vetëm nga fytyrat e ndryshme (po aq sa të njëjta) të liderëve të tyre respektiv. Në këtë rrafsh, interesi politik i qytetarit është në minimum. Kësisoj politikani nuk është gjë tjetër veçse një profesion privat si shumë të tjerë. Detyra e tij nuk është më që të përfaqësojë interesat e atij që ia delegoi pushtetin, por që të ushtrijë pushtetin për hir të qëndrimit sa më të gjatë në pushtet. Kjo është fytyra e re e qeveritarit-burokrat që del nga politikat “përtej së majtës dhe të djathtës”. Këtij qeveritarit pra që nuk përfaqëson më një interes publik dhe që i vetmi instrument që ka populli për ta kontrolluar është thjesht dhe vetëm një votim çdo 4-5 vjet.

mekanizmave të dekonstruktivizimit dhe nihilizimit post-modern shkatërron çdo gjë që e pengon gjatë rrugës, duke përforcuar pozitën e qeveritarit dhe duke formësuar tipare të një lideri despotik mbi-ideologjik. Në këto kushte garat elektorale fokusohen kryesisht mbi performancat e liderëve nëpër debatet para-zgjedhore kundër njërit-tjetrit, më shumë se sa në platformat e tyre politike. Brenda një sistemi që funksionon nëpërmjet kësaj ideologjie mpirëse, qytetari nuk është asgjë më shumë sesa turma e vetmuar e metropoleve në pritje të fjalimeve udhërrëfyese të demagogut. Qytetari nuk ka më vendimmarje, por ai vetëm vendos se cili do të jetë ai që do të vendosi për të thjesht duke shënuar një kryq në fletën e votimit përbrri emrit të kandidatit që lëshoi batutën më të mirë për gjatë debatit para-zgjedhor, demagogut të podiumeve që e vetëlegjitimoi ideologjia e asgjësë. Ideologji e cila i filtrohet “qytetarit të turmave” nëpërmjet asgjësë mediatike, asgjësë

artistike, asgjësë shpirtërore si dhe asgjësë akademike.

Por ajo që është më interesante shfaqet në momentin kur kjo ideologji e asgjësë tronditet nga kriza të tipit socio-ekonomik brenda vetë strukturave shtetërore. Në momente të tilla, aparati ideologjik shtetëror për të fituar sado pak legjitimitet dhe për të qetësuar turmat e revoluara vë në përdorim mekanizmat e ideologjisë nacionaliste. Në këto kushte nacionalizmi mbetet arma e vetme në dorë të aparatit ideologjik shtetëror për të maskuar dhe justifikuar disi mungesën drastike të dimensionit social-politik në asgjënë politike shtetërore. Nga kjo mund të dilet në përfundimin se sa më e rëndë të jetë situata socio-ekonomike, aq më i pranishëm bëhet filtrimi i ideologjisë nacionaliste si instrument i vetëm legjitimiteti nga ana e aparatit shtetëror. Jo rastësisht politikant “përtej së majtës dhe të djathtës” në vëndë të tilla si Italia, Franca dhe së fundmi Greqia janë shoqëruar nga prania e një

dimensioni mjaft të theksuar shovinist në ideologjinë shtetërore. Gjithë kësaj forme distributive të ideologjisë e cila filloi qysh me problemet në lidhje me diskriminimin e emigrantëve në Itali dhe problemet në lidhje me veshjen e hijabeve në Francë nuk kishte se si t'i shpëtonte dhe shovinizmi grek pas këngët anti-shqiptare, anti-turke dhe anti-maqedonase. Kësisoj gjithë ky vakum ideologjik, në mungesë të mobilizimit të grupeve të shoqërisë mbi baza sociale me synim krijimin e qytetarit politikisht pasiv, instrumenti më i fuqishëm që i mbetet tashmë shtetit është ksenofobia dhe nacionalizmi radikal karshi grupeve më të marxhinalizuara të shoqërisë. Ky nacionalizëm i shfaqur veçanërisht në momente krizash të thella socio-ekonomike kryen rolin e një opozicioni ndaj problemeve reale të këtyre shoqërive. Zhgënjimet e vazhdueshme të natyrës sociale pasqyrohen në lehtësinë e mobilizimit të masave ndaj këtyre kauzave sipas idesë “varfërisë s'kam ç't'i bëj por të paktën jam patriot i patundur”. Ashtu siç shkruante

Hobsbawm, “nacionalizmi militant ishte një refleksim i dëshpërimit. Ishte utopia e atyre që humbën utopitë e kohës, programi i atyre që e humbën besimin në program të tjerë.” Brenda kontekstist post-ideologjik, bashkë me të gjitha zhgënjimet dhe mosbesimin e thellë ndaj platformave politike që ai sjell, mund të thuhet se janë të gjitha kushtet e lulëzimit të shovinizmit dhe ksenofobisë. Sa më shumë të shtohet hendeku social, aq më shumë kjo pabarazi e skajshme ka premisa të kthehet në një faktor determinues të një rimëkëmbjeje të fashizmit. Në këto kushte nacionalizmi mbetet i vetmi burim mbështetjeje në popull nga ana e të pushtetshëmve si dhe komponenti më i fuqishëm i superstrukturës shtetërore post-ideologjike. Kristalizimi i shovinizmit nuk është gjë tjetër veçse një rrjedhojë e revoltave sociale të munguara dhe për shmangien e këtij rreziku, roli kryesor kursesi nuk është i aparatit shtetëror por vetëm e vetëm i popullit, ose të paktën asaj pjese që ende e njej veten si të tillë.

(Vijon nga faqe 2)

...Kjo matricë, tipikisht franceze, këmbëngul përgjatë historisë sonë. Në 1940, rigjejmë figurën katastrofike të dështimit ushtarak si pretekst për çorientimin e madh: për shembull, një qeverisje që flet vetëm për "komb" por, që është vendosur prej të huajit; oligarkë të korruptuar deri në kockë, por që paraqiten si ata që do të nxjerrin vendin nga një krizë e madhe morale; aventurier, mbret ngordhalaq, ushtarak i vjetër ose politikan i paskrupullit, gjithnjë ekzekutues për të kamurit e mëdhenj dhe që paraqitet si ruajtësi i vërtetë i energjisë kombëtare.

A nuk vëmë re edhe sot, si përsëritje e njerë e këtyre depresioneve të rënda historike që Franca ia përplas vetes, trajta të shumta të këtij lloji?

Së pari, në këtë tip situatë "pétainiste", kapitullimi dhe serviliteti paraqiten si shpikje, revolucion dhe ripërtëritje. Eshhtë thelbësore për Sarkozynë ta zhvillojë fushatën me motivin e thyerjes, ndryshimit. Thyerje, reforma të thella, lëvizje të pashtershme si ato të mushkonjave: Sarkozy njofton se do të kapërcëjë krizën morale të Francës, se do ta rivendosë në punë. Eshhtë gjithsesi e mrekullueshme t'u thuash njerëzve, në gjendjen ku ndodhen, nga lartësia e kostumit të kryetarit të bashkisë së Neuillys: "Unë, do ju vë të punoni!" tamam sikur të ishte borgjezja e e shekullit XIX tek i drejtohej shërbëtores. Por jo, është thyerja, është risia. Përmbajtja është sigurisht bindja pa rezervë ndaj kërkesave të pushtetarëve të kapitalizmit të botësuar. Situata ushtarake është biznesi i amerikanëve, situata e brendshme ajo e financierëve të mëdhenj, etj. Goditet vetëm i varfri, i dobi, të huajt. "Thyerja" në realitet është politika e gjynjzimit të pandërprerë, gjë që paraqitet si politikë e ripërtëritjes kombëtare. Ky është çorientim tipikisht pétainist: serviliteti përpara të fuqishmëve të sotëm (fitimtarët nazistë dhe bashkëpunorët e tyre të skajit të dhjathhtë) është quajtur prej Shefit "revolucion kombëtar" kur jemi shi në majë të kapitullimit dhe shërbëtorisë së pranuar, flasin për ringritje morale dhe për të ardhme të ripërtëritjes. Duhet shumë punë për të gjetur një çorientim më të madh se ky. Kjo figurë, besoj, është e jona dhe nuk shoh shumë ekuivalent në kombe të tjerë, të paktën mes atyre që pretendojnë se kanë një rol madhor në skenën e botës, siç ishte qartazi rasti i Francës në vitet '40. Ky singularitet sigurisht që nuk është motiv krenarie patriotike...

Kriteri i dytë i pétainizmit është motivi i "krizës", "krizës morale", dhe justifikon masat e marra në emër të ripërtëritjes. Konstatohet një rënie kombëtare, dekadencë kërcënuese, së cilës do t'i dalim për zot menjëherë. Këtë rënie (pëlqehet të thuhet sot "perëndim") mund t'ia ngjisim një krize morale: dallimi mes së mirës dhe së keqes, puna, familja, atdheu janë në krizë. Meqë kjo krizë është morale, ringritja nuk supozon në asnjë mënyrë energjinë e ndonjë mobilizimi politik të njerëzve. Përkundrazi, prej këtij mobilizimi do të ruhem në mënyrën më efikase dhe me mjetet policore më drakoniane. Morali vjen siç e bën gjithnjë, në vend të politikës, kundër politikës, krejt kundër politikës së bërë prej njerëzve të popullit. Do t'i thërresim atëherë ringritjes morale, punës, ekonomisë familjare, terminologji saktësisht pétainiste, gjë që lejton të thuhet se shteti, ai vetë, është i ngarkuar për të realizuar gjithçka, meqënëse njerëzit janë të përfshirë në gjendjen e krizës morale. Në errësirën e krizës duhen nderuar vetëm individët që, me thirrjen e shtetit dhe shefit të tyre, bëjnë përpjekje të lavdërueshme kundër

rënies. Për shembull, ata që kënaqen shumë kur punojnë gjashtëdhjetë orë në javë. Këta do i kënaqim me një medalje çokollate. Siç e thotë njeriu i minjve, duhet "shpërblyer merita".

Për dialektikën mes moralit dhe politikës, tipikisht pétainiste, duhet thënë se është përgatitur prej shumë kohësh dhe prej të gjithë atyre që, duke filluar me "filozofët e rinj", nga fundi i viteve '70, "moralizuan" gjykimin historik, dhe zëvendësuan kundërvënien themelore mes politikës barazitare të emancipimit dhe politikës jobarazitare konservatore, me kundërvënien e shteteve despotikë dhe gjakësorë me shtetet e së drejtës, pa na shpjeguar gjithsesi origjinën e masakrës madhështore që po kryhej mbi planetin mbarë, përgjatë një shekulli e gjysëm, prej këtyre shteteve të "së drejtës". Kjo sepse qëllimi i këtij moralizimi është në realitet politik. Ata duhet të thonë se gjendja e vendit nuk është aspak rezultati i veprimit të shërbëtorëve të mëdhenj të kapitalit dhe klientelës së tyre mediatike dhe politikane, por faji i njerëzve, faji i "moralitetit" të qytetarëve dosido. Sarkozy na shpjegon se, nëse bashkëqytetarët tanë janë zhytur në një krizë morale që po e shpie vendin në rënie, kjo sepse, siç e ka zbuluar ai, e ka shkaku në majin e vitit '68. Mirëpo, maji '68 është ai i njerëzve, i të rinjve studentë, i punëtorëve, intelektualëve, i atyre që e bënë. Dhe, nëse maji '68 e tremb akoma Sarkozynë dhe minjtë e tij, kjo ndodh se ata hamendësojnë, jo pa të drejtë, se njerëzit vazhdojnë të besojnë pak a shumë ose t'i referohen kësaj ngjarjeje. Pasi janë njerëzit, veçanërisht të rinjtë e lagjeve popullore dhe punëtorët me prejardhje të huaj, ata që sipas njeriut të minjve janë vepruesit e krizës së rëndë morale. Eshhtë faji i këtyre pisanjosve nëse vendi rrënohet, nëse rrëzohet në çast. Fatmirësisht, Sarkozy dhe shteti vëzhgojnë. Ata vetëngarkohen me tërësinë e veprimeve të ripërtëritjes dhe thyerjes. "Kriza morale" është gjithnjë një shprehje që ka për qëllim ta bëjë shtetin fuqiplotë, duke argumentuar papërgjegjshmërinë e të qeverisurve, veçanërisht atë të më të varfërve dhe më të dobtëve. Si riparohet një krizë morale me mjete shtetare, kjo padyshim nuk është shumë e qartë. Çka është e sigurt, është se duhen marrë masa energjike, dhe këto sido që të jetë, do të merrën. Kjo është ajo çka do të mbetet nga rrënuja moralizuese: polici, drejtësi, kontroll, përjashtim, ligj inkriminues, sistem burgosës. Vetëkuptohet, i shoqëruar nga pasurimi i të pasurve, gjë që është e Mira par excellence.

Kritika e tretë e pétainizmit: funksioni paradigmatik i përvojave të huaja. Shembulli i ringritjes vjen gjithnjë nga jashtë. Të huajt veprojnë gjithnjë më mirë se ne, ata janë ringritur që prej kohësh. Kanë kapërcyer pa dobësi krizën morale. Në vendet "e mira" të

Nga libri "De quoi Sarkozy est-il le nom ?"

# "Pétainizmi" si trashëndental i Francës



hin ende prej këtyre ngjarjeve. Preferonin më mirë gjermanët, nazistët, s'ka rëndësi se çfarë, përballë Frontit popullor. Prej ku dhe pohimi sipas së cilit Fronti popullor është origjina dhe simboli i krizës së rëndë morale që kërkohet, me ndihmën e mirëpritur të pushtesit nazist, revolucionin kombëtar. Për presidentin tonë, rasti i fundit, i përgjegjshëm për krizën e vlerave është maji '68-ës. Kjo krizë ka nevojë edhe për rikonfigurimin e gjithë vendit tonë fatkeq, në udhën e zhbërjes së përshpejtuar, sipas modelit të Bushit ose Blairit. Pétainizmi ka brenda vetes një element historik që konsiston në lidhjen e dy ngjarjeve, një ngjarjeve negative, përgjithësisht me strukturë punëto-re dhe popullore, dhe një ngjarje pozitive, me strukturë shtetare, elektorale dhe/ose ushtarake. Një prej forcave të pétainizmi qëndron te lexueshmëria e thjeshtuar e historisë. Për Sarkozynë, kjo lexueshmëri mbulon një hark mjaft të madh, dyzet vjet historie, nga maja e dekadencës, maji i '68-ës, te maja e ringritjes, njeriu i minjve dora vetë. Kjo lexueshmëri është burim ligjshmërie për qeverinë e re, pasi çdo ligjshmëri e këtij tipi është lidhje mes shtetit dhe historisë. Qeveria paraqitet vetvetiu si aktor historik i rëndësishëm së parë meqënëse i përket asaj që, në fund të fundit, të marrë masat për ringritjen e domosdoshme në lidhje me ngjarjen bazë të së keqes.

Elementi i pestë është racialist. Nën regjimin e Pétainit thuhej thjesht që qartë: të mbarojmë punë me çifutët, metekët, zezakët... sot thuhet, në mënyrë më të matur, por që kuptohet prej një veshi të ushtruar: "Ne nuk jemi (nënkuptohet: ndryshe nga të tjerë) një racë inferiore. Franca nuk ka pse merr mësimë prej askujt, gjithë ç'ka bërë ajo është e mirë dhe një francez i vërtetë nuk ka pse dyshon ligjshmërinë e veprimeve të vendit të vet." Sarkozy ka shikuar shumë larg në këtë drejtim duke mos hezituar të na krahasojë me afrikanët, në favorin tonë kuptohet. Ai ua bëri të ditur se, përballë nesh, ata vlenin shumë pak, dhe se, për rrjedhojë, nëse janë të njerzë në atdheun e tyre, meqë është faj i tyre, aty duhet të qëndrojnë. Ne, francezët e Francës, kemi detyrat tona, vlerat dhe fatet tona, ekzistencën tonë dhe atyre do t'ia u përkushtojmë përpjekjen tonë. Sigurisht, na duhen shesaxhinj, mbledhës plerash, hapës kanalesh... do t'i përzgjedhim një për një dhe janë të lutur të mos bëjnë rrëmujë tek ripërtpypin, si të integruar keq, inferioritetin e tyre të qartë. Si në rastin e Pétainit, u gjend përsëri një klikë intelektuale që duartrokitën arrogancat racialiste të njeriut të minjve.

Le të përmbledhim edhe njëherë pesë trajtat formale që përkufizojnë transhendentalin pétainist. Së pari, çorientimi i përfutur nga përmbysja e artë e përmbajtjes reale të veprimit të shtetit: revolucion aty ku ka reaksion të zi, rigjenerim kur kapitulohet, liri të re kur jemi në majë të servilitetit. Së dyti, tema antipolitike e krizës morale që dërrmon popullin dhe i lë duart e lira shtetit për të organizuar forma të reja të shtypjes. Së treti, motivi i ngjarjes së keqe, origjinë dhe simbol i rënies morale, ngjarje që është gjithnjë episod shënjesës i provave politike punëto-re dhe popullore (Revolucioni në fazën e tij robespierriste, Komuna e Parisit, Fronti popullor, maji i '68-ës). Së katërti, funksioni paradigmatic, vlera e modelit të ringritjes, figurat më shenjuese të reaksionit më të skajshëm jashtë Francës. Së pesti, variantet e ndryshme të epërsisë së qytetërimit tonë mbi popullsitë e huaj (për shembull, afrikanët), por gjithashtu mbi "minoritetet" brenda Francës (për shembull, të rinjtë arabë).

Nisur prej këtyre kritereve, le ta themi pa hezituar se Sarkozy i përket transhendentalin pétainist.

Te gjithë armiqtë kane patur frike nga armiqtë e tyre

# Jacque Ranciere: "Deleuze përmbush destinin e estetikës"

Dejona Mihali

Studimet e Deleuze-it mbi artin, për letërsinë (Proust, Melville, Laërence, Beckett) për pikturën (Bacon, Fromanger) apo për kinemanë (L'image-mouvement dhe L'image-temps), bënë të mundur që disa artistë e filozofë të dalloheshin për nga mënyra në të cilën ata i hapen njëri-tjetrit. Por rrallë është shtruar pyetja nëse ekziston diçka e cila mund të quhet "estetikë Deleuziane". I rastisi Jacques Rancière-it ta pozonte këtë pyetje me gjithë qartësinë që nevojitej ("Existe-t-il une esthétique deleuzienne?" in E.Alliez, ed, Gilles Deleuze. Un vie philosophique, Synthelabo, 1998). Mbase sepse ideja e një "estetike" ishte në vetvete problem për të, ishte objekt i kërkimit të tij gjenealogjik. Në veprën e tij, ai solli faktin se estetika është emri i një regjimi specifik të artit, më shumë sesa një i tillë (datuar që nga shekulli i 19-të) dhe për më tepër, interesantja është se: Deleuze "përmbushi destinin e tij". Kjo në fakt është diçka të cilën s'mundemi ta injorojmë: mbi të gjitha nëse ky destin mbartet me vete ontologjinë si politike-të-filozofisë (shih kapitullin La Chair des mots, Galilee, 1998: "Deleuze, Bartleby et la formule littéraire"). Në një nga librat e tij të fundit (La Fable cinématographique), një koleksion mbi kinemanë, Rancière rikthehet tek pozicioni singular i Deleuze-it dhe tek tensioni që shfaqet ai ("nga një imazh në tjetrin. Deleuze dhe mosha e kinemasë"). Deleuze i Flaubert-i i ditëve të fundit? Pse jo...

Gilles Deleuze mund ta lexoni në shqip në dy botime: "Ç'është filozofia?" dhe "Filozofia Kritike e Kantit" përkthyer nga Elvis Hoxha, Zenit Editions. Ndërkohë që vepra e parë e Jacques Rancière në shqip "Mosmarrëveshja" tashmë e përkthyer pritet të botohet së shpejti.

Në vazhdim po paraqesim një intervistë të Jacques Rancière në revistën "Littéraire" në shkurt të vitit 2002.

**David Rabouin: Si ndodhi që filluar të interesoheshit për veprën e Gilles Deleuze?**

**Jacque Rancière:** Njëpërjetje të tjerëve në fakt. Unë kam qënë kolegë i Deleuze-it për një kohë shumë të gjatë, në Paris VIII, por jo vetëm, ndonëse s'kam ndërjerë ndonjë afinitet për shkrimet e tij. Pas vdekjes së tij, u organizuan një numër i madh aktivitetesh ku të pranishmit dëshiron të përfshinin disa këndvështrime të cilat ishin disi më "të jashtme". Duhet thënë se një pjesë të madhe të teksteve të tij kam filluar t'i lexoj vonë, edhe pse padyshim njihja shumë mirë një seri prej tyre dhe kjo për shumë arsye. Për shembull kisha studiuar Nietzsche-n e Deleuze-it ndërkohë që përgatisja tezën time, Proust-in e tij sepse më interesonte, Anti - Oedipus për shkak të polemikave dhe përdorimit politik në kohën kur u botua; por gjithsesi shumë tekste i kam parë veç për së largu dhe jam interesuar për to nga ndërmjetësimi i dy gjërave: së pari nga kërkesa që m'u bë për të folur mbi Deleuze-in si një anti-Deleuzian, dhe së dyti nga shqetësimet e mijta, në funksion të të cilave unë kam pasur privilegjin të lexoj tekste të veprës së tij të cilat dikush mund t'i quaj estetike.

**David Rabouin: Kjo paragjykim estetik**



**prodhon disa efekte interesante. Kur dikush lexon studimet që i keni kushtuar Deleuze-it, edhe mbi letërsinë, edhe mbi pikturën apo kinemanë, ndalet për të parë se në fakt ka një pozicion konstant pavarësisht nga diferenca e objekteve të tij. A mund të shtrohet që këtu pyetja juaj, nëse ekziston diçka si "Estetika Deleuziane"?**

**Jacque Rancière:** Unë në fakt jam i prekur, edhe kur bëhet fjalë për pikturën, edhe për letërsinë apo kinemanë, nga i njëjti trajtim fundamental i Deleuze-it. Ai operon në dy momente: gjithmonë, afirmimi i një lloj materialiteti radikal, imanen ndaj shprehësisë piktoriale, të folurit e letërsisë - për kinemanë është në fakt pak më e komplikuar - afirmimi pra, i një lloj karakteristike të objektit piktorial apo letrar; por, në një moment të dytë, ai prodhon një lloj kthimi. Për shembull, ajo çfarë duket të jetë një përkufizim për pikturën duke nisur prej një rrjeje formale zbulohet të jetë si një përshkrim i lloj historie. Do të thoja nëse flisim këtu për Baconin i cili është gati gati mjeshtri i transformimit të çdo kavace në një alegori të pikturës, më pas në një alegori të pikturës në vetvete. Deleuze na tregon në secilin pikturë një punë mbi Figurën ku ajo shfaqet e sulmur nga forcat e jashtme, në përpjekje për evakuar vetveten por në fund e mbetet në vend. Secila pikturë bëhet një lloj kryqëzimi ose një "Figurë e dhunimeve" e cila është alegoria e gjithshkajë të pikturës. E njëjta gjë ndodh dhe me letërsinë. Për shembull, Deleuze literalizon formulën e Proustit duke iu referuar me anë të së cilën shkrimtari krijon një gjuhë tjetër me gjuhën; ai na tregon gjuhën e Kafkës të shqyer nga gjuha e Gregorit tek Metamorfoza ose Melville mbetet gjuha e zakonshme, e paafektuar nga tingulli që ajo përshkruan. Deleuze duket atëherë të alegorizojë këtë gjuhë tjetër të pagjetshme në transformimin e tipareve fiksonale të përmbledhur në përshkrimin e karaktereve tek tiparet e gjuhës. Kam treguar të njëjten gjë për kinemanë në respekt të kësaj thyerje të motorit-sensor të skemës e cila, duke iu referuar atij, e ndan kinemanë në dy mosha: atë të imazhit-lëvizje dhe atë të kohë-imazhit. Këtu përsëri

thyerje është tashmë e ilustruar nëpërmjet tipareve fiksonale: është rasti i këmbës në allçi i James Stewart tek Rear Window ose marramendja e tij në Vertigo (A. Hitchcock) e cila vepron si një figuracion i paralizës së motorit - sensor dhe po kështu e kalimit nga një moshë e imazhit të kinemasë në një tjetër.

I njëjti mekanizëm shfaqet disa herë. Sikur Deleuze ta bënte artin një kritike radikale të përfytyrimit, të drejtuar drejt një lloji të një imanence totale; dhe në të njëjtën kohë, sikur kjo imanencë duhet gjithnjë të transformohet menjëherë në diçka si alegoria apo skenari, i cili nëse flasin siç duhet është një skenar metafizik, dhe që në çdo rast supozon që çdokush riintegrohet ose riinveshohet në një model masiv gjithshka që varet nga aspekti fiksonal ose historik i pikturës, i filmit apo i romanit.

**David Rabouin: Dhe kjo provokon një lloj tensioni: sikur mënyra e vetme për të dalë nga regjimi i përfytyrimit të ishte sjellja në ballë e tipareve përfytyruese. Ju thonë që në këtë tension Deleuze "përmbush destinin e estetikës"**

**Jacque Rancière:** Po, ai përmbush destinin e çfarë unë quaj "regjimi estetik" i artit, një regjim që dëshiron të ndahet nga tradita përfytyruese. Tani, ndarja me këtë traditë nuk mund të bëhet nëpërmjet mënyrave të thjeshta. S'mund të bëhet, sikundër mund të mendojë ndokush, në favor një autonomie të thjeshtë të veprës së artit, ku vepra e nxjerrë nga përfytyrimi mund t'i dorëzohet një lirie ose një lloj imanence radikale. Ky vizion është jashtëzakonisht thjeshtëzues. Regjimi estetik i një veprë arti nuk është thjeshtë autonomia e veprës, por në fakt është gjithmonë një autonomi e pëzier me heteronominë. Nuk është një regjim i thjeshtë i vullnetit të lirë artistik, por një regjim në të cilin ky vullnet i lirë është gjithmonë i lidhur me diçka si për shembull pesha e të pavetëdijshmes, e pasives, e të pavullnetshmes. Është imanencë, nëse preferonim por jo një imanencë e thjeshtë.

(Vijon numrin e ardhshëm)

**Çfarëdo qoftë rëndësia e faktorëve të tjerë shoqëruar ose kushteve, është e pamundur të kuptosh sjelljen e njerëzve të përfshirë në ngjarje të tilla pa parë në to materializimin e afekteve ekstremisht të forta të urrejtjes**

Nga Cornelius Castoriadis

Ndoshta do ketë pasur luftëra të cilat kanë mobilizuar vetëm shtypa të "limituara" agresive, përfshirë për shembull minimumin e agresionit të angazhuar në vetëmbrojtje. Por ajo për të cilën kemi qenë dëshmitarë tashmë, në Europë dhe Afrikë, po ashtu dhe në Azinë lindore gjatë luftës së dytë botërore, është shpërthimi i një agresioni të pamatë, i shprehur nëpërmjet racizmit, vrasjet indiskriminuese të civilëve, përdhunimet, shkatërrimin e monumenteve dhe banesave, vrasjes dhe torturat e të burgosurve. Dhe ajo çfarë dimë për historinë e forcave njerëzore na bën të mendojmë se inovacionet e fundit në këtë fushë qëndrojnë përgjithësisht tek dimensionit sasior dhe tek instrumentat teknik të fenomenit, si dhe tek artikulumit me imagjinaren e grupeve të lidhur me të, por aspak në natyrën e tyre. Çfarëdo qoftë rëndësia e faktorëve të tjerë shoqëruar ose kushteve, është e pamundur të kuptosh sjelljen e njerëzve të përfshirë në ngjarje të tilla pa parë në to materializimin e afekteve ekstremisht të



# Rrënjët psikike dhe sociale të urrejtjes

fora të urrejtjes. Do të përpiqem të paraqes ekzistencën e dy burimeve të urrejtjes, ku njëra forcon tjetrën: - shtypa themelore e Psike-

zëm" për ta karakterizuar atë, dhe e pëlqente këtë gjendje primordiale të qenies njerëzore, përfshirë funksionin e të ushqyerit të nënës, deri te plotësia e një veze zogu.

E tillë mbyllje bëhet, për psike-në, matrica e domethënies. Më saktesisht, çfarë bërthama psikike do të "kuptojë" ose "konsiderojë" tani e përgjithmonë, si domethënie është kjo gjendje e "njëjesisë", ku "subjekti" dhe "objekti" janë identikë dhe ku përfytyrimi, afekti, dhe dëshira janë një dhe të njëjta sepse dëshira është përfytyrimi imediat (posesioni psikik) i kënaqësisë së dëshiruar rrjedhimisht edhe i afektit (e cila është dhe forma më pastër dhe e fortë e omnipotencës së mendimit). Kjo është domethënia që Psike-ja do të gjëmtojë

Freude ka pasur një parqitje të shkurtër mbi këtë vetë-mbyllje. Ai përdori fjalën e Bleuler-it "auti-

zëm" për ta karakterizuar atë, dhe e pëlqente këtë gjendje primordiale të qenies njerëzore, përfshirë funksionin e të ushqyerit të nënës, deri te plotësia e një veze zogu.

E tillë mbyllje bëhet, për psike-në, matrica e domethënies. Më saktesisht, çfarë bërthama psikike do të "kuptojë" ose "konsiderojë" tani e përgjithmonë, si domethënie është kjo gjendje e "njëjesisë", ku "subjekti" dhe "objekti" janë identikë dhe ku përfytyrimi, afekti, dhe dëshira janë një dhe të njëjta sepse dëshira është përfytyrimi imediat (posesioni psikik) i kënaqësisë së dëshiruar rrjedhimisht edhe i afektit (e cila është dhe forma më pastër dhe e fortë e omnipotencës së mendimit). Kjo është domethënia që Psike-ja do të gjëmtojë

përgjithmonë. Sigurisht, që nuk do të jetë i arritshëm në "botën reale", dhe zëvendësimi për të do të vijë në formën e serive të gjata të meditimit ose të vizioneve "mistike" të pajala. Pa kuptuar këtë, nuk do të jemi kurrë në gjendje të kuptojmë pse identifikimi me personat, me detyrën, me kolektivitetet, me shenjeshmërinë, me institucionet është proces kaq i fuqishëm dhe i gjithëpranishëm në jetën psikike. Po ashtu s'mund të kuptojmë pse shoqëria, gati pakufishmërisht, mund të luajë me plasticitetin e Psike-së - me kushtin e vetem, i cili është, që shoqëria të pajisë subjektin me domethënie (duke folur rigorozisht, një zëvendësim social për domethënie) në "jetën reale".



Nga momenti (ndoshta si një limit teorik ose "ideal") kur kjo gjen-dje e hershme e "qetësisë psikike" thyhet, (dhe e thyrë duhet të jetë nëse fëmija do të mbijetojë), "energija" fillestare e kësaj vetëdashurie ndahet në tre pjesë: një pjesë e saj mbetet si vetë-kathexis e bërthamës së psikes, dhe ndikimi i saj implikon të gjitha fazat pasardhëse në zhvillimin e subjektit të psikikës dhe shtresat korresponduese të personalitetit matur; një pjesë tjetër transferohet, nën formën e vetes, kraharorit/gjirit: Ich bin die Brust është një nga fjalitë e fundit që shkroi Freud; pjesa e fundit transformohet në urrejtje për "botën e jashtme", të cilës duhet t'ia shohim këtu kuptimin: gjithshka që është e huaj monadës psikike, e cila rrjedhimisht përshin Avatarët e zhvillimit psikik dhe somatik "Realitet - Ego". Pjesa e parë (vetëdashuria e mbetur) konsiderohet si egoizëm i paqrrënjoshëm, që pak a shumë në një mënyrë e maskuar me fine-së, dominon në analizë të fundit të gjitha mendimet dhe veprat tona. Nga një pikë tjetër vështrimi që në pamje të parë duket si jo me shumë lidhje, ajo për të cilën po flasim këtu është egoizmi ontologjik domosdoshmërisht imanent për çdo qenie - për - veten. Kudo dhe gjithnjë, unë jam origjina e kordinatave kohore dhe hapsinore; e imja këtu dhe tani është KËTU-ja dhe TANI-ja; bota është përfytyrimi im.

Dy pjesët e tjera mpleksen dhe ngatërrohen shumë shpejt. Që nga ambivalenca themelore e të gjitha afekteve, si fillim, e deri tek marrëdhënia me dashuri-objektin e parë, nënën. Ato ngatërrohen sepse kraharori/gjiri "ngatërrohet shumë shpesh nga fëmija". Mungesa e e gjirit mund të ishte shtuar drejt shkatërrimit të totalitetit të mbyllur të fëmijës, si pasojë në një trënim të kuptimit për botën e saj/e tij.

Fillimisht, ky shkatërrim është lehtësuar nga një krijim imagjinar, halucinacioni i gjirit. Kur ky halucinacion i gjirit dëshon së qeni i aftë për të mbuluar prishjen e mbylljes origjinore monadike, fëmija mbetet më një boshllëk pre humnere në botën e tij, dhe reagon me ankth e tërbim. Ky boshllëk, kjo mungesë e gjirit është një keqkuptimshëmëri. Dhe këtu, si gjithnjë, keqkuptimshëmëria, ose aktualja dhe e pashmangëshmjia, reale ose e imagjinuar, shkatërrim i kuptimit, është burim i ankthit. Meqë fëmija posedon rudimentet e inteligjencës induktive, që është të kuptuarit e diçkaje në lidhje me përsëritjen dhe rregullsinë, themelohet shpejtësisht kështu një lidhje midis boshllëkut dhe kujtesës për një objekt i cili "normalisht" e mbush atë. (Zakoni bëhet normal që prej faktit se i korrespondon dëshirës). Ky karakteri apo vlera e këtij objekti ndahet në dy attribute kontradiktore, kraharoret e mirë dhe të këqinj. Këto attribute, dhe afekt e dëshirat i shoqërojnë ato (e thënë shkurti-

miht, dashuri dhe urrejtje), janë transferohen në vazhdimësi tek imazhi që është i lidhur me gjirin/kraharorin, nënën si një entitet ose person. Kjo bëhet matrica e ambivalencës që tash e tutje do të jetë inherente në çdo marrëdhënie të subjektit. Por ka diçka më shumë në lidhje me këtë proces, që është diçka shumë e rëndësishme. Rezultati i procesit të maturimit/socializimit është formimi i individit social, i cili në vetvete është, nga këndvështrimi i bërthmës monadike të psikes, një "objekt" i huaj dhe i çuditshëm. (Në terma Freudian, Realitet -Ego, ekspozon të gjitha atributet që janë kontradiktore me atë të Dëshirë - Ego). Kështu që të dy bëhen mbështetës për transferimit të vetëdashurisë dhe një objekti të urrejtjes tek momenti i psikikes "joreale", urrejtje që, siç tashmë është parashtruar, ia ngarkon çfarëdo që është "e jashtme" bërthamës psikike. Realiteti -Ego nuk mund të arratiset nga të qenit objekt i ambivalencës së afekteve. Zakonisht, dashuria ndaj Egos mbizotëron mbi urrejtjen e atij çka është objekti, mjaftueshmërisht, më çdo kusht, për të garantuar mbijetesën e subjektit në jetën reale. Por urrejtja e Egos vazhdon jetën e saj të pazhurshme në thellësi të Psikes. Kështu sipas këndvështrimit psikoanalitik ekzistojnë dy vektorë të urrejtjes. Së pari, urrejtja për "tjetrin real", që është thjeshtë e kundërta e anës pozitive të vetë-kathexit. Kjo mbahet e gjitha nga sofizëm elementar dhe i fuqishëm që është gjithashtu i pranishëm në format kolektive të urrejtjes dhe neverisë dhe ndoshta është më e thjeshtë të dallohet në format e saj të hershme: Jam i mirë; (e) mira është unë; ai nuk është unë; Ai nuk është i miri (ose është më pak i mirë se unë). Unë jam francez, (amerikan, italian, britanik, etj.); për të qenë francez (amerikan, italian, britanik ...) është të jesh (i) mirë; ai nuk është francez (amerikan, italian, britanik...); si rrjedhim, ai nuk i mirë.

E dyta është vetë-urrejtja. Për veten, Egoja, është një nga të huajt e parë të homologëve të psikes. Ky është dhe kuptimi i frazës së Rimbaud-së, "Unë është një tjetër", një kuptim që nuk është dhe aq i ndryshëm nga ç'duket, kuptimi i tij prima facie: për "Unin" ose Egon, esencialisht një konstrukt social, nuk është më "mua" më shumë seç është një fqinj apo një kalimtar i rastit. Në të kundërt me çfarë besohet përgjithësisht, kjo vetë-urrejtje është universale. Ajo qartësisht mund të mbijetojë veç nëse zbutet ashpërsisht ose zëvendësohet ndaj objekteve me të vërtetë "të jashtme". Nëpërmjet këtij zëvendësimi, subjekti mund të mbajë afektin ndërkohë që ndërron objektin e tij. Ky proces është më i dukshëm në fenomenin e racizimit, të cilit do t'i rikthehem së shpejti.

(Vijon numrin e ardhshëm)



## CORNELIUS CASTORIADIS Filozofi që frymëzoi revolucionin e majit të vitit 1968 në Francë

**Përgatiti: Dejona Mihali**

Castoriadis, filozofi i politikës së autonomisë dhe imagjinatës sociale, bashkëthemelues i grupit të famshëm Socialisme ou Barbarie dhe revistës më të njëjtin emër për gjatë viteve '48 - '67. Së bashku me Claude Lefort, Jean-François Lyotard dhe Guy Debord.

Cornelius Castoriadis (1922-1997), ishte filozofi, mendimtari politik, kritiku social, psikoanalist praktikues, Sovietologjist dhe ekonomist i cili zhvilloi një kritikë radikale të Komunizmit bazuar tek ideja e organizimit të punëtorëve dhe përçoi një ndikim frymëzues në revolucionin e studentëve dhe punëtorëve në Paris në Majin e 1968 (Manifesto 1949 S.B.) i gjithë mendimi i tij i shkruar në

esetë mbi politikën, shoqërinë, psikoanalizën, filozofinë dhe imagjinatën u udhëhoq nga perspektiva e tij e "projektit të autonomisë".

I lindur në Konstandinopojë në 1922, familja e tij largohet prej andej pak muaj më pas për shkak të luftës Greko-Turke. Anëtar i Partisë Komuniste Greke (që në moshën 17 vjeçare) gjatë regjimit të Metaxa-së. Shpjet formon fraksionin e tij radikal trockist dhe përfundon në listat e vdekjes së fashistë dhe "komunistëve" reaksionare grekë.

Largohet nga Athina e para luftës civile në dhjetor të 1945 për në Paris. Pjesa më e madhe e shkrimeve të tij u publikuan nën pseudonimin Paul Cardan, deri në kohën kur në Greqi emri i tij s'ishte pjesë e ndonjë liste për dënim me vdekje.

Profesor në École des Hautes Études en Sciences Sociales, dhe autor i një serie veprash që lanë shenjë e një epoke që rirënditi mendimin njerëzor dhe u bë masë frymëzuese për ngjarjet më të mrekullueshme konceptualisht, njerëzisht, politikisht, revolucionarisht...

"Disidenti esencial" do të quhej nga l'Humanite në shkrimin që shënonte humbjen e tij në 1997.

Shkrimi i mëposhtëm është shkëputur nga libri "Figures de pensable: carrefours du labyrinthe" nga kapitulli "Psyché".

Publikimi për herë të parë në Gazeta i C. Castoriadis është njëkohësisht dhe botimi për herë të parë në shqip. Në numrat në vijim do të kenë mundësinë të lexoni disa pjesë themelore po nga ky libër.



# falli i fallit

## e parathëna -1984

Krenar Zejno

1984. Orwell, 1948. Invertim profetik, befas një mit: Big Brother.

Shqip - një përkim kryefund tragjik me asokohën kur Vëllai i Madh ballkanik përçor, zë e përçartet shtruar mu në bash të vendit, bash kur një farë Gjergj Oruelli i paskej përçuar në fall tërë ditarin utopik të kuvendit që në krye të herës e gjer në duhmën funeste të tiranit Si, vallë! Si në valle ku vallëzojnë tok dy shtojzovalle



Aty nga vitet tridhjetë, Oruelli ecejakej

"Pa një dyshkë nëpër Paris e Londër", si një titull libri i atij vetë.

Si militant i bredhur, na qënkej takuar me Tarasin tonë rishtar në celulë përçimi të ideve kuqashe të Kominternit ngadhynjimar.

Të dy, me prirje për fallxhorë, u bënë miq tek i shtinin fall njëri - tjetrit, orë e pa orë.

Tarasi i shihte filxhanin, tjetri shquante historinë që mikut i shfaqej ndër shenjat e vijave në dorë.

Shtangu e për një çast u këndell kur anglezi po i shihte fallin, e që të vijonte, i hodhi me kast dy kacidhe, siqë ia dinte tjetrit hallin.

Për dy franga dhe pa e bërë dysh, Oruelli fallxhor ia rrëfeu mbarë ardhmërinë bukurshut tonë të përkorë.

Pastaj e yshti që të mos e merrnin m'sysh për fatin e rrallë që i pat këqyrur në dorë.

Ngurrur prej ngërçit, Oruelli pat lexuar tmerrin më të pështirë të njerëzisë: Legjendën e Përçit.

Pa e përçmuar rastin fatlum që i mbiu në dorë të mikut, shkruesi e hedh të zezë mbi të bardhë, e si vepër të tij ia vërvit këtë pabesi njerëzim.

Mandej, me ndoca erëza pikante saksone ia gatit botës që ajo ta gëlltitë si Legjendë të Përçudnimit.

Me ta parë, shfaqur ndër dorën e Tarasit si në një film ardhmërie, Njeriun Fringo, Ekranet, Gjuhën e Re, e krejt mënyrën,

Oruellit s'do t'i lypsej shumë marifet për ta shkruar një libër dhe për ta gjetur në këtë mënyrë dhe botuar gjithë mënyrën.

Zëfilli e pat titulluar "Njeriu i fundmë në Evropë", pastaj e zuri rrëfimin përfund dhe e pagëzoi me emër fundfalli të numëruar.

Njerëzia, që si gjithëherë mezi shquan, e që nuk di se numri flet, ende, sot e gjithë ditën, e quan libri i shekullit të njëzetë.

Dituria e kohës e përçgas Oruellin me Nostradamus, dhe për të kuptuar historinë librin e tij e mban si kyç.

Por historia e dy militantëve rishtarë krejt ndryshe na paskej qenë si në një lojë të lojtur zaresh kumari mbi kuadratin për yç.

Kështusoj, Tarasi i posanzënë, gjithë ç'do bënte vaki, ç'prej kreut e gjer në fund, e paskish pasur të parathënë.

Në këmbim të ndonjë napoloni flori, Oruelli shtrëngohej të dëgjonte edhe turpe e paudhësira nga Tarasi i pangjinjur.

Baba Çeni, edhe ato dy kacidhe që kish, ia dërgonte nipit që të na bënte shkollë të madhe, mirëpo ky i uruar,

në vend të dëftesës, i postonte ungjit çmimet e sallatrave ruse të menusë së gjelltores së Parisit, të cilat

Baba Çeni i gjerë i hante si nota për t'u lëvduar.

Një përkthyes i moshuar i dëftoi Çenit se dëftesa e fundit e nipit, ku shkruhej Universi i Ped... (mbetja e palexueshme mbet e pakuptuar), s'ishte gjë tjetër veçse fletushkë e klubit të natës, ndërsa notat e larta 25 deri 30, ishin centimetra gjatësi fallusi pa ndonjë lidhje me

Universitetin e Pedagogjisë që çaprazte i paudhi në letren e sajuar.

Baba Çeni jepte e merrte me mendje të kuptonte: nëse nipi i tij e jepte, apo e merrte.

Por, s'i dilte që s'i dilte hesapi se si nipi i prapë, edhe kur e merrte, paguante prapëseprapë.

Përkthyesi bënte be e rrufe' që as atij vetë s'ia rrokte mendja, ngaqë në perëndim shpërblimi është tepër i koldavitur sidomos kur bëhet fjalë për qejfin e harbuar.

Baba Çeni, sidoqoftë, i dhimbsej nipi.

Vëllai i madh, babai i vërtetë i djalit, s'ish më për këtë botë.

Ai haraksej sokakëve, e kujtdo që shihte me karpuz në dorë, i qepej këmba-këmbës, t'ia rëmbente e ngjiste veshin për ta kërcitur mes duarve.

Pastaj sokëllinte me të madhe, në do dilte a s'do dilte i kuq.

Njerëzia ia bënte jetën malore duke e ndjellë prej qafës së sokakut me ndonjë topt, ngaqë ia dinin këtë huq.

Më vonë, kur Tarasi themeloi Gjuhën e Re, edhe për t'u harruar bëma e atit, i gjeti fruit të mallkuar një emër po aq erotik, disi më të qëruar.

Paskëtaj e s'ekëtejmi përshëndoshte nga tribunat me grushtin grusht dhe fill pas pabesisë së anglezit, që fallin e botëroi për libër,

e hapi pëllëmbën për ta yshtur hapur mizërinë shesheve tek kundronte poshtazi mizorinë. Fall in love.

Tarasit s'i mbetej veç të lante hesapet me Oruellin e t'i jepte udhë hallit. Shkruesin e gjetën të vdekur, pak kohë pasi kish dalë në dritë libri i fallit.

Fët e fët shkuli ambasadën angleze, qepi kufirin tejndanë,

preu fillin me botën, dhe e la fallin të bënte hatanë. Fall by itself.

Për t'i prerë shtegun edhe qesëndisë në "Fermën e Kafshëve"

vendosi që mbi këtë dhë të mos hynte më libër, as derr as dosë.

Kur e kish pisk me mjerimin pllakosur, dilte dhe i bërtiste Anglisë që t'i kthente sa më parë qypat e florinjve të ashtuqajtur satrapit.

Por anglezi gjithaq englez, na i quante haraç këmbimi për kopjimin

e projektit të Oruellit pa të drejtë përdorimi. Ec e gjeje si leshtë e arapit!

Sidoqoftë, çdo gjë vaj e tamam sipas fallit,

gjithçka në vije, si në vijat e dorës në kohrat e mallit.

Veç një gjë po i vinte përkundër: makti

se mos ai libër, kush drejtin e di, binte në dorë të djallit.

Qëkurse iu faneps se Oruelli, tek i bënte „Homazh Katalonjës"

në luftën e Spanjës, mund t'i kish rrëfyer për fallin

një shehu komandant partizan, Tarasi u dalldis.

Sapo i lau duart me të, krahun e tij të djathtë, i mbiu në kokë

se mos ky i kishte shfryrë bëmën e fallit miqve të shtëpisë.

Ndaj hartoi listën pa hamendje dhe nisi gjëmën ta bitisë.

Fall Down.

(Vijon numrin e ardhshëm)